ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.a.

PASQYRAT FINANCIARE
PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2014

Tabela e përmbajtjes

Raporti i audituesit të pavarur i
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse 1
Pasqyra e pozicionit financiar 2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital 3
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare 4

Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare
1. Historiku i shoqërisë 5
2. Bazat e përgatitjes 5
3. Politika të rëndësishme kontabël 6
4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara 13
5. Standarde të reja 14
6. Menaxhimi i rrezikut financiar 16
7. Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit 18
8. Kosto e shërbimeve të realizuara 18
9. Shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative 18
10. Shpenzime tatim fitimi 19
11. Aktive afatgjata materiale 20
12. Aktivet afatgjata jomateriale 21
13. Tatim fitimi i shtyrë 22
14. Inventari 22
15. Llogaritë e arkëtueshme 23
16. Aktive të tjera 23
17. Mjete monetare 24
18. Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve 24
19. Rezervat 26
20. Dividendët 26
21. Fitimi për aksion 26
22. Të ardhura e papërfituara 27
23. Provigjonet 27
24. Llogaritë e pagueshme 28
25. Shpenzime të përllogaritura dhe detyrime të tjera 29
26. Instrumentet financiare 29
27. Palët e lidhura 34
28. Pensionet e stafit dhe shpërblimet pas daljes në pension 38
29. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara 38
30. Ngjarje pas datës së raportimit 40

pwc

Raport i audituesit të pavarur

Për aksionarët dhe Bordin e Drejtorëve të Albanian Mobile Communications sh.a.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të Albanian Mobile Communications sh.a. ("shoqëria") të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2014 dhe pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe informacion tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon si të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar e evidencën e auditimit rreth shumave dhe shënimeve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të anomalive materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare me qëllim që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinioni

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2014, si dhe të performancës së saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin ushtrimor e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Jonid Lamllari
Auditues Ligjor

16 qershor 2015
Tiranë, Shqipëri

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr Ibrahim Rugova, Sky Tower, kati 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F:+355 (4) 2241 639, www.pwc.com/al

Regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 15 korrik 2009 me Numër Identifikimi të Personit të Tatueshëm NIPT K91915023A

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.a.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE
(në mijë Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Të ardhurat operative			
Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit	7	11,270,057	12,203,572
Të ardhura nga shitja e aparateve telefonike dhe aksesorëve	7	141,604	246,422
Totali i të ardhurave operative		**11,411,661**	**12,449,994**
Kosto e shitjeve dhe shërbimeve të ofruara			
Kosto e shërbimeve të realizuara	8	(6,614,750)	(6,224,453)
Kosto e shitjes së aparatëve dhe aksesorëve		(155,170)	(290,767)
Totali i kostos së shitjeve dhe shërbimeve		**(6,769,920)**	**(6,515,220)**
Fitimi Bruto		**4,641,741**	**5,934,774**
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	26	(64,719)	(101,084)
Shpenzimet e përgjithshme, të shitjes dhe administrative	9	(3,305,166)	(3,824,478)
Shpenzime të tjera		218,977	(61,576)
Fitimi operativ neto		**1,490,833**	**1,947,635**
Të ardhurat dhe shpenzime financiare			
Të ardhura nga interesat		1,569,396	2,251,622
Komisione dhe tarifa të tjera bankare		(24,815)	(20,079)
(Humbje)/të ardhura neto nga kursi i këmbimit		(107,325)	244,807
Totali i të ardhurave financiare, neto		**1,437,256**	**2,476,350**
Fitimi para tatimit		**2,928,089**	**4,423,985**
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	10	(485,035)	(300,065)
Fitimi për vitin financiar		**2,443,054**	**4,123,920**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse		**2,443,054**	**4,123,920**
Fitimi bazë dhe i pakësuar për aksion (Lek)	19	3,002	5,067

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.a.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
(në mijë Lekë)

	Shënime	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
Aktivet			
Aktive afatgjata materiale	11	10,007,475	11,120,931
Aktive afatgjata jomateriale	12	1,948,169	2,165,927
Aktiv tatimor i shtyrë	13	718,811	724,281
Hua të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	-	10,531,312
Llogari të arkëtueshme	15	73,063	84,952
Aktive të tjera afatgjata	16	196,699	11,906
Totali i aktiveve afatgjata		**12,944,217**	**24,639,309**
Inventari	12	351,181	411,045
Llogari të arkëtueshme	15	1,217,669	1,569,155
Të tjera llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	817,330	455,069
Hua të arkëtueshme nga palët e lidhura	27	-	31,766,000
Aktive financiare të mbajtura deri në maturitet	27	55,459,701	6,433,550
Tatim fitimi i arkëtueshëm	8	675,841	493,072
Aktive të tjera afatshkurtra	16	1,217,058	1,218,056
Mjete monetare	17	6,176,349	9,487,419
Totali i aktiveve afatshkurtra		**65,915,129**	**51,833,366**
Totali i aktiveve		**78,859,346**	**76,472,675**
Kapitali			
Kapitali aksionar	18	813,822	813,822
Primi i aksioneve	18	13,184	13,184
Rezerva	19	23,677,017	23,677,017
Fitimi i pashpërndarë		49,075,504	46,632,450
Totali kapitalit		**73,579,527**	**71,136,473**
Detyrime			
Të ardhura të shtyra	22	338,547	182,021
Provigjone	23	113,628	107,671
Totali i detyrimeve afatgjata		**452,175**	**289,692**
Llogaritë e pagueshme	24	2,147,750	2,627,611
Detyrime ndaj palëve të lidhura	25	1,383,670	942,049
Të ardhura të shtyra	22	779,817	781,820
Detyrime të tjera afatshkurtra	25	471,114	423,099
Provigjone		45,293	271,931
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**4,827,644**	**5,046,510**
Totali i detyrimeve		**5,279,819**	**5,336,202**
Totali kapitalit dhe detyrimeve		**78,859,346**	**76,472,675**

Pasqyra e pozicionit financiar duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i Albanian Mobile Communications sh.a. më dhe janë firmosur në emër të tij më 25 Maj 2015 nga:

Dimitrios Blatsios
Drejtor Ekzekutiv

amc
ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS SH.A
Rr. Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë. Tel 04 2275000
NIPT J61814094W

Dimitrios Paschos
Drejtor Financiar

amc
ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS SH.A
Rr. Gjergj Legisi, Laprakë, Tiranë. Tel 04 2275000
NIPT J61814094W

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.a.

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
(në mijë Lekë)

	Shënime	Kapitali Aksionar	Primi i Aksioneve	Rezerva	Fitimi i Pashpërndarë	Total
Gjendja më 1 janar 2013		813,822	10,303	23,677,017	42,508,530	67,009,672
Fitimi i vitit		-	-	-	4,123,920	4,123,920
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		-	-	-	4,123,920	4,123,920
Opsione për aksioneve	18	-	2,881	-	-	2,881
Gjendja më 31 dhjetor 2013		**813,822**	**13,184**	**23,677,017**	**46,632,450**	**71,136,473**
Gjendja më 1 janar 2014		813,822	13,184	23,677,017	46,632,450	71,136,473
Fitimi i vitit		-	-	-	2,443,054	2,443,054
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		-	-	-	2,443,054	2,443,054
Gjendja më 31 dhjetor 2014		**813,822**	**13,184**	**23,677,017**	**49,075,504**	**73,579,527**

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS Sh.a.

PASQYRA E LËVIZJEVE TË MJETEVE MONETARE
(në mijë Lekë)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013
Flukset monetare nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Fitimi neto para tatimit		**2,928,089**	**4,423,985**
Rregullime:			
Amortizimi	10, 11	2,669,873	2,785,385
Aktive afatgjata të çregjistruara		23,204	16,739
Humbja/(fitimi) nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		(20,618)	595
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	26	64,719	105,237
Kthimi i humbjeve nga zhvlerësimi (borxhet e mbledhura)	26	-	(4,153)
Shpenzime financiare neto		(1,540,949)	(2,229,644)
Rimarrje shepnzime per penalitete		(13,288)	-
Diferencat e parealizuara nga kursi i këmbimit		116,628	(255,290)
Pagesat e bazuara në aksione të shlyeshme nëpërmjet kapitalit	18	-	2,881
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin qarkullues		**4,227,658**	**4,845,735**
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme		302,076	211,690
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura		(360,996)	(176,460)
Ndryshimi në inventar		59,864	43,550
Ndryshimi në aktivet e tjera afatshkurtra		(182,337)	38,624
Ndryshimi në detyrimet ndaj palëve të lidhura		442,003	164,770
Ndryshimi në llogaritë e pagueshme		(363,636)	274,893
Ndryshimi në të ardhurat e shtyra		154,524	8,554
Ndryshimi në provigjone dhe detyrime të tjera afatshkurtra		(217,527)	(40,238)
Mjete monetare të krijuara nga veprimtaria e shfrytëzimit		**4,061,629**	**5,371,118**
Pagesat për tatimin mbi fitimin		(649,045)	(529,381)
Interesat e paguara		(24,815)	(20,079)
Paraja neto nga veprimtaria e shfrytëzimit		**3,387,769**	**4,821,658**
Flukse monetare nga veprimtaria e investimit			
Blerjet e aktiveve afatgjata	10, 11	(1,478,569)	(2,153,412)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		20,618	4,678
Interesa të arkëtuar		788,710	2,320,851
Investime në aktive financiare të mbajtura deri ne maturitet	27	(54,412,116)	(6,315,695)
Arkëtime nga aktivet financiare	27	48,382,518	7,000,740
Paraja (përdorur në)/neto nga veprimtaria e investimit		**(6,698,839)**	**857,162**
(Rënia)/rritja neto në mjetet monetare		**(3,311,070)**	**5,678,820**
Mjete monetare më 1 janar		9,487,419	3,808,599
Mjete monetare më 31 dhjetor	17	**6,176,349**	**9,487,419**

Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese në faqet 5 deri 40, të cilat janë pjesë përbërse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Historiku i shoqërisë

Albanian Mobile Communications Sh.a. (më poshtë referuar "AMC" ose "Shoqëria") u themelua si një shoqëri me kapital aksionar më 22 nëntor 1995 dhe është e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në bazë të vendimit nr. 12910 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit të subjektit J61814094W.

85% e aksioneve të kapitalit të shoqërisë zotërohen nga COSMOHOLDING Albania S.A, një shoqëri 100% e zotëruar dhe kontrolluar nga Cosmote Mobile Telecommunications S.A. ("Cosmote"). Gjatë vitit 2009, Cosmote bleu dhe pjesën e mbetur prej 12.68% të aksioneve që zotëroheshin nga Qeveria Shqiptare dhe gjatë vitit 2010 bleu edhe 2.08% që përbënte pjesën e aksioneve të zotëruara nga aksionarë të tjerë pakice. Pronësia e mbetur prej 0.24% i përkasin aksionarëve pakicë. Shoqëria mëmë e gjithë grupit është Deutche Telecom AG ("DTAG"), Bon, Gjermani.

Aktiviteti kryesor: Shoqëria është një operator telekomunikimi përqendruar në ofrimin e telefonisë celulare (lëvizëse). Që prej vitit 2003, AMC fitoi një licencë për të ofruar shërbime të transmetimit të të dhënave për 5 vite, ndërkohë që prej datës 26 dhjetor 2008, AMC zotëron "Autorizimin e Përgjithshëm" për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit, i cili përfshin edhe shërbimet e transmetimit të të dhënave dhe si rrjedhim, rinovimi i licencës së vjetër për transmetimin e të dhënave nuk është më i nevojshëm. Gjatë vitit 2011, AMC u pajis me licencën 3G për të operuar në rrjetin 2100 GSM. Gjatë muajit Janar 2015, shoqëria rinovoi licensen GSM për një periudhë 15 vjecare. Kosto totale e rinovimit ishte 1,525,019 mijë Lekë. Gjatë muajit Mars 2015, shoqëria fitoi një tender publik të organizuar nga Autoriteti i Telekomunikacionit për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTES/WiMAX për një periudhe 15 vjecare. Kosto totale e të drejtave ishte 1,268,635 mijë Lekë. Gjatë muajit Prill 2015, shoqëria fitoi tenderin publik të organizuar nga nga Autoriteti i Telekomunikacionit për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 2500-2690 MHZ. Kosto totale e këtyre të drejtave ishte 423,312 mijë Lekë.

Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e biznesit: Adresa e regjistruar dhe vendndodhja kryesore e shoqërisë është Rruga "Gjergj Legisi" Laprakë, Tiranë, Shqipëri.

2. Bazat e përgatitjes

(a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe interpretimet përkatëse të publikuara nga Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar (KIRFN), në përputhje me Ligjin nr. 9228 datë 29 Prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike.

(b) Monedha funksionale dhe ajo raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në lekë shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Monedha funksionale është monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilën shoqëria kryen veprimtarinë e saj. Të gjitha informacionet financiare të raportuara në Lekë janë rrumbullakosur në mijëshen më të afërt (nëse nuk specifikohet ndryshe).

(c) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon kryerjen e gjykimeve, vlerësimeve dhe supozimeve nga ana e drejtimit, të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë periodike. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën rivlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme të ndikuara. Në mënyre të veçantë, informacioni në lidhje me pjesët e rëndësishme ttë vlerësimit ose gjykimeve kryesore në zbatim të politikave kontabël që kanë ndikimin më të rëndësishëm në shumat e paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet në vijim:

- Shënimi 10 – Shpenzimi i tatimit dhe Shënimi 29 iv
- Shënimi 15 – Llogaritë e arkëtueshme dhe Shënimi 26 - Instrumentet financiare
- Shënimi 23 – Provigjonet
- Shënimi 29 – Angazhimet dhe detyrimet apo aktivet e kushtëzuara

Politikat kontabël në vijim janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare

3. Politika të rëndësishme kontabël

a) Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare përkthehen sërish me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Të gjitha diferencat respektive si pasojë e kësaj të fundit njihen si fitim ose humbje.

b) Instrumentet financiare

Instrumentet financiare të shoqërisë gjatë vitit 2014 dhe 2013, përbëhen nga instrumente financiarë jo-derivative: hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare (përfshirë depozitat e mbajtura deri në maturitet), aktive financiare të mbajtura deri në maturitet dhe llogaritë e pagueshme. Shoqëria nuk ka instrumente financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes apo të disponueshme për shitje në datën e raportimit.

(i) Njohja fillestare

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare llogariten në datën e tregtimit, data kur shoqëria angazhohet të blejë apo shesë aktivin. Instrumentet financiare jo-derivative njihen fillimisht me vlerë të drejtë. Kostot e transaksionit përfshihen për instrumentet që nuk klasifikohen si të mbajtur me vlerë të drejtë.

(ii) Matjet e mëpasshme

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Në mjetet monetare dhe të ngjashme përfshihen balanca e mjeteve monetare në arkë, llogaritë bankare rrjedhëse dhe depozitat bankare afatshkurtër. Për qëllim të pasqyrës së lëvizjes së flukseve monetare, në mjetet monetare dhe të ngjashme përfshihen depozita të pakushtëzuara me afat maturimi më pak se tre muaj nga data e fillimit. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre maten më vonë me kosto të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme

Huatë dhe të llogaritë e arkëtueshme maten më vonë me kosto të amortizuar minus ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Të llogaritë e arkëtueshme me afat të shkurtër nuk aktualizohen.

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet përfshijnë aktivet financiare të kuotuara jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse që shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturitet. Menaxhimi përcakton klasifikimin e letrave me vlerë të investimeve të mbajtura deri në maturitet në njohjen e tyre fillestare dhe rivlerëson përshtatshmërinë e klasifikimit në fund të çdo periudhe raportuese. Aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet mbahen me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, neto nga ndonjë dispozitë për humbjet e shkaktuara nga zhvlerësimi.

Llogaritë e Pagueshme

Llogaritë e pagueshme maten me kosto të amortizuar.

Fitimet ose humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktivet dhe pasivet financiare te mësipërme çregjistrohen ose zhvlerësohen, si dhe nëpërmjet procesit të amortizimit. Kontabilizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare diskutohet në shënimin 3 (m).

(iii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar në qoftë se ka një evidence objektive që një ose më shumë ngjarje që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, kanë pasur efekt negativ në flukset monetare të çmuara për këtë aktiv.

Vështirësitë financiare të debitorëve, probabiliteti i falimentimit apo riorganizimi financiar i debitorit si dhe mashtrimet e gabimet ne pagesa, janë disa shembuj treguesish për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(b) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iii) Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Aktivet financiare testohen për zhvlerësim individualisht. Aktivet financiare që mbeten, testohen për zhvlerësim në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë.

Humbja nga zhvlerësimi që lidhet me aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë mes vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivit financiar.

Vlera kontabël neto e aktivit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie të zbritjes dhe vlera e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi vazhdojnë të përllogariten mbi vlerën e mbetur të zvogëluar bazuar në normën fillestare të interesit efektiv. Llogaritë e arkëtueshme së bashku me llogaritë e zbritjes, çregjistrohen kur nuk ka perspektive realiste për rikuperim në të ardhmen.

Në qoftë se, në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjeve nga zhvlerësimi ulet dhe kjo ulje vjen për shkak të një ngjarjeje që ka ndodhur pasi është njohur zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi i njohur në periudhat e mëparshme do të anulohet nëpërmjet rregullimit të llogarisë së zbritjes. Në rast se anulimi rikthehet, shuma njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(iv) Çregjistrimi

Aktivet financiare çregjistrohen kur të drejtat kontraktuale të shoqërisë ndaj flukseve monetare shuhen, ose kur aktivi financiar i transferohet palëve të tjera pa mbajtur kontrollin apo rreziqet dhe përfitimet prej aktivit financiar. Detyrimet financiare të shoqërisë çregjistrohen kur përfundojnë, shlyhen apo anulohen.

(v) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe paraqiten neto në bilanc, në qoftë se dhe vetëm në qoftë se ekziston një e drejtë ligjore për të kompensuar shumat e njohura dhe qëllimi që shlyerja të realizohet mbi baza neto, apo të realizohet aktivi dhe shlyhet detyrimi njëkohësisht. Ky është dhe rasti i tepricave të të drejtave dhe detyrimeve ndaj operatorëve të telekomunikacionit, që shlyhen mbi baza neto në përputhje me kontratat ekzistuese

(vi) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e mjeteve monetare, të llogarive të arkëtueshme dhe të drejtave të tjera, të llogarive të pagueshme dhe të detyrimeve të tjera, është e ngjashme me vlerën e mbartur të tyre, si pasojë e maturitetit afatshkurtër.

Vlera e drejtë e huave të arkëtueshme nga palët e lidhura është përafërsisht e barabartë me vlerën e tyre të mbartur sepse huatë janë me interes të luhatshëm i cili reflekton ndryshimet në kushtet e tregut.

(c) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe Matja

Aktivet afatgjata materiale maten me koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kostot e antenave të shoqërisë përfshijnë edhe kostot e vlerësuara për çmontim, largim dhe restaurim të vendeve ku ndodhen (shënimi 23). Programet kompjuterike të blera që lidhen në mënyrë integrale me funksionimin e pajisjeve janë kapitalizuar si pjesë e aktivit.

Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si elemente të ndarë (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

(ii) Kostot e mëpasshme (vazhdim)

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivit material afatgjatë kapitalizohen kur, ka mundësi që shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga ky aktiv dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e elementëve që zëvendësohen, çregjistrohet. Të gjithë kostot e tjera njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse siç ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi regjistrohet duke u bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Jeta e dobishme e aktiveve për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Ndërtesa (aktive administrative)	20 vjet
• Ndërtesa të rrjetit	10 vjet
• Instalimet dhe sistemet e telekomunikacionit	5-10 vjet
• Kompjutera (aktive administrative)	3 vjet
• Pajisjet e transportit (aktive administrative)	6-7 vjet
• Mobilie e orendi (aktive administrative)	5 vjet

Jeta e dobishme, metodat e amortizimit dhe vlerat e rikuperueshme, kur janë të rëndësishme, të aktiveve afatgjata materiale janë rivlerësuar në çdo datë raportimi përmes një komisioni të përbërë nga personel teknik. Gjatë vitit 2014, shoqëria ka rishikuar jetët e dobishme të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, të cilat mbetën të pandryshuara në krahasim me periudhat e mëparshme.

(iv) Çregjistrimi

Aktivet afatgjata materiale çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nga shitja apo përdorimi i tyre, nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen. Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit apo shitja e aktiveve afatgjata materiale përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël neto dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

(d) Aktivet afatgjata jomateriale

Aktivet afatgjata jomateriale përfshijnë licencat.

(i) Njohja dhe matja

Licencat e blera nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi, në rast se ka të tilla.

(ii) Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse ato rrisin përfitimet ekonomike të ardhshme për aktivin në fjalë. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në fitim/humbje kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke u bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit duke filluar nga data kur aktivi ka qenë i disponueshëm për t'u përdorur. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata jomateriale për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Licenca	3-7 vjet
• Licenca 3G	15 vjet
• Programet kompjuterike	3 vjet

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare
Në çdo datë raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësimin e aktiveve. Në rast se ekzistojnë këta tregues, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Për aktivet afatgjata jomateriale që ende nuk janë të disponueshme për t'u përdorur, vlera e rikuperueshme përcaktohet në çdo datë raportimi. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera kontabël neto e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivet e tjera. Humbjet nga zhvlerësimi regjistrohen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e aktivit apo njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe asaj të drejtë minus kostot e shitjes. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara skontohen duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specifik të aktivit.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet kur ka tregues që humbja nga zhvlerësimi nuk ekziston më dhe kanë ndryshuar supozimet e përdorura në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme të aktivit.

Humbja nga zhvlerësimi anulohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivit nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pasi të ishte zbritur zhvlerësimi apo amortizimi, nëse zhvlerësimi nuk do të ishte njohur.

(f) Inventari
Inventarët që përfshijnë kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesorët përkatës dhe kancelari e pajisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me më të voglën midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i çmuar në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe realizimit të shitjes. Kosto e inventarëve llogaritet mbi bazën e metodës mesatare dhe përfshin kostot e kryera për blerjen dhe sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale. Pajisjet dhe aksesorët që u jepen klientëve falas në këmbim të abonimeve të reja regjistrohen në shpenzime shitjeje dhe administrative në fitim/humbje kur ato ndodhin.

(g) Dividendët
Dividendët njihen si detyrim në periudhën që deklarohen.

(h) Përfitimet e punonjësve
(i) Pensionet e detyrueshme
Gjatë aktivitetit normal të biznesit, shoqëria kryen pagesa kontributesh për llogari të saj dhe të punonjësve për të kontribuar në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e kryera për llogari të shoqërisë në këtë skemë me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

(ii) Pagesa e lejeve vjetore
Shoqëria njeh si detyrime shumën e paaktualizuar të kostove të vlerësuara në lidhje me lejet vjetore që pritet të paguhen në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën që mbyllet.

(iii) Transaksionet e pagesave bazuar në aksione
Vlera e drejtë e opsionit të dhënë punonjësve njihet si shpenzim për punonjësit dhe në të njëjtën kohë rrit primet e aksionit gjatë periudhës që punonjësi ka të drejtë të pakundërshtueshme kundrejt opsioneve. Shuma që njihet si shpenzim është rregulluar për të reflektuar shumën aktuale të aksioneve për investim. Shoqëria nuk mund të çmojë me saktësi vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimeve të përfituara dhe si pasojë dhe vlerën e tyre të drejtë, dhe rritjen respektive në kapitalin aksionar duke iu referuar vlerës së drejtë të instrumenteve të dhëna të kapitalit. Instrumentet e kapitalit të ofruar i referohen aksioneve të OTE S.A., shoqëria mëmë e Cosmote S.A.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Provigjonet
Provigjonet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si pasojë e një ngjarjeje të shkuar dhe për të shlyer detyrimin do të kërkohet një përdorim i burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin për të cilin mund të kryhet një vlerësim i besueshëm. Nëse efekti i kohës është domethënës, provigjonet përcaktohen duke aktualizuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit që reflekton kushtet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimit, kur është e nevojshme. Provigjonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe kur mundësia e përdorimit të burimeve me përfitime ekonomike nuk është i mundur dhe i nevojshëm për të shlyer detyrimin, ato të rimerren.

Provigjonet përdoren vetëm për shpenzimet për të cilat u njohën fillimisht dhe jo për humbje të ardhshme operative. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara nuk njihen, por paraqiten në shënimet shpjeguese kur ato janë të konsiderueshme.

(j) Qiratë
Qiratë klasifikohen si qira financiare apo operative që në fillim të qirasë. Për qiratë e pagueshme të klasifikuara si qira operative referojuni shënimit 3l (i).

(k) Njohja e të ardhurave

Shërbimet
Të ardhurat nga shërbimet njihen në fitim/humbje në proporcion me përfundimin e shërbimit në datën e raportimit. Të ardhurat nga shërbimet përbëhen nga ato në vijim:

(i) Tarifat e abonimit
Te ardhurat e lidhura me tarifat mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet.

(ii) Tarifat e përdorimit dhe tarifat për shërbimet shtesë
Tarifat e thirrjeve konsistojnë në tarifa për kohën e bisedës dhe trafikun e gjeneruar nga telefonuesi, destinacionin e telefonatës dhe shërbimin e përdorur. Tarifat e përdorimit bazohen në trafikun e gjeneruar, përdorimin e kohës së bisedës ose volumin e transmetimit të të dhënave për shërbimet shtesë, si mesazhet e shkurtra, përdorimin e internetit dhe shërbimin e të dhënave.

Të ardhurat nga tarifat e përdorimit dhe shërbimet shtesë njihen në periudhën kur këto shërbime u sigurohen abonentëve. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimeve, në datën e fundit të çdo muaji vlerësohen bazuar në trafikun e gjeneruar dhe regjistrohen në fund të çdo muaji.

Të ardhurat nga shitja e kartave telefonike me parapagim dhe kohës së parapaguar, të përfshira në paketën e shoqërisë për shërbimet e parapaguara, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

(iii) Tarifat roaming
Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, operatorët e tjerë të rrjeteve celulare faturojnë shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur janë kryer shërbimet.

(iv) Tarifat e interkonjeksionit
Trafiku i gjeneruar midis dy shoqërive të telekomunikacionit menaxhohet përmes procesit të interkonjeksionit. Shoqëria e telekomunikacionit e abonentit që kryen një thirrje pëson në të njëjtën kohë një shpenzim ndërsa shoqëria ku telefonata përfundon realizon një të ardhur duke faturuar shoqërinë e telekomunikacionit të abonentit thirrës.

Të ardhurat e interkonjeksionit realizohen nga telefonatat e përfunduara në rrjetin e AMC ndërkohë që janë gjeneruar nga rrjete të operatorëve fiks apo lëvizës vendas apo të huaj.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(k) Njohja e të ardhurave (vazhdim)

(iv) Tarifat e interkonjeksionit (vazhdim)

Të gjithë regjistrimet që kanë AMC si numër thirrës dhe një abonent të një shoqërie tjetër si numër të thirrur, krijojnë një shpenzim për AMC. Kostot e interkonjeksionit burojnë nga të gjithë thirrjet që krijohen në rrjetin e shoqërisë dhe përfundojnë në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare të huaja dhe vendase, duke përdorur rrjetet e shoqërisë. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në fitim/humbje në momentin kur thirrja mbërrin në rrjetin e shoqërisë (në rrjetin e operatorëve të tjerë).

Mallrat

Të ardhurat nga shitja e aparateve celularë dhe aksesorëve, pasi zbriten zbritjet, njihen me livrimin e tyre kur titulli dhe rreziqet e shpërblimet e pronësisë i kalojnë klientit.

Në disa raste, marrëveshjet e abonimit të klientëve përfshijnë shitje pajisjesh dhe shitje shërbimesh. Shoqëria e konsideron shitjen e pajisjeve dhe të shërbimeve si të ndara nga pikëpamja e procesit të të ardhurave dhe i klasifikon të ardhurat për çdo shpërndarje duke përdorur metodën e mbetur për çdo element. Këto njësi identifikohen dhe ndahen, duke qenë se kanë vlerë në mënyrë të ndarë dhe shiten bashkërisht por gjithmonë të ndara. Në këtë mënyrë, shoqëria njeh të ardhurat për këta elementë duke përdorur metodën e mbetur sipas të cilës shuma e konsideratës së shpërndarë ndaj elementëve të marrëveshjes barazon konsideratën totale pas vlerës së drejtë të elementëve të pashpërndarë.

(l) Shpenzimet

(i) Shpenzimet e qirasë

Shoqëria merr linja me qira kryesisht nga Albtelecom Sh.a. për të lidhur rrjetin e saj me rrjetin e linjave fikse të Albtelecom Sh.a. Shpenzimet e qirave operative njihen në fitim/humbje në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë. Përfitimet e marra njihen si pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë përgjatë afatit të qirasë.

(ii) Shpenzimet e reklamës

Të gjitha kostot e marketingut njihen si shpenzime kur ndodhin dhe përfshihen në shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative në fitim/humbje.

(iii) Subvencione dhe komisione

Subvencionet për klientët e rinj ose ekzistues nëpërmjet distributorëve ose dyqaneve njihen në fitim/humbje kur ato ndodhin. Komisionet varen nga e ardhura që sjell abonenti ose koha që abonenti qëndron në rrjet. Ato llogariten dhe njihen në fitim/ humbje në baza mujore.

(m) Të ardhura financiare

Të ardhurat nga interesat njihen në fitim/humbje në bazë të parimit të të drejtave të konstatuara, duke përdorur normën efektive të aktivit përkatës.

(n) Tatimi mbi fitimin

Tatimet mbi fitimin janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që konsiderohet si i tillë në fund të periudhës raportuese. Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim/humbjen e vitit, përveç rastit kur njihet në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose drejtpërdrejt në kapital për shkak se ka të bëjë me transaksionet që janë të njohura në të njëjtën ose një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ose në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i parashikuar për t'u paguar ose rimbursuar nga organet tatimore, i përllogaritur mbi fitimin e tatueshëm për periudhën aktuale ose ato paraprake. Fitimet ose humbjet e tatueshme janë të bazuara në parashikime nëse pasqyrat financiare janë autorizuar përpara plotësimit të deklaratave përkatëse të tatim-fitimit. Tatimet e tjera mbi të ardhurat janë të regjistruara në kuadër të shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, si pasojë e ekzistencës së diferencave të përkohshme midis vlerës së mbartur te aktiveve dhe detyrimeve për qëllime te raportimit financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(n) Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Në përputhje me përjashtimin në njohjen fillestare, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për ato diferenca të përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose detyrimi në një transaksion tjetër përveçse një kombinimi biznesi, nëse transaksioni nuk ndikon as në fitimin kontabël dhe as në fitimin e tatueshëm. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

(o) Fitimi për aksion

Fitimet bazë dhe ato të pakësuara për aksion llogariten duke pjesëtuar fitimin neto me mesataren e ponderuar të numrit të aksioneve gjatë çdo viti.

(p) Vlerat krahasuese

Vlerat krahasuese rregullohen që të përputhen me vlerat e vitit aktual, kur është e domosdoshme për të korrigjuar gabimet në prezantim të viteve të kaluara, në rast se ka të tilla.

Gjatë vitit, shoqëria ka ndryshuar prezantimin e komisioneve të faturuara nga agjentët dhe ndërmjetësit e saj në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse. Më parë këto shuma kompensoheshin me të ardhurat duke i prezantuar të ardhurat e shoqërisë neto, ndërkohë që në vitin 2014 komisionet janë prezantuar si shpenzime të shitjes. Shoqëria është e mendimit që ndryshimi në prezantim jep informacion më të besueshëm dhe të rëndësishëm. Në përputhje me SNK 8, ndryshimi është bërë retrospektivisht duke ndikuar të ardhurat operative dhe fitimin bruto sic është prezantuar më poshtë. Fitimi neto nuk ka ndryshuar.

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013	Riklasifikim	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 i riparaqitur
Të ardhurat operative			
Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit	11,840,238	363,334	12,203,572
Të ardhura nga shitja e aparateve telefonike dhe aksesorëve	246,422		246,422
Totali i të ardhurave operative	**12,086,660**	**363,334**	**12,449,994**
Kosto e shitjeve dhe shërbimeve të ofruara			
Kosto e shërbimeve të realizuara	(6,224,453)		(6,224,453)
Kosto e shitjes së aparateve telefonike dhe Aksesorëve	(290,767)		(290,767)
Totali i kostos së shitjeve dhe shërbimeve	**(6,515,220)**		**(6,515,220)**
Fitimi Bruto	**5,571,440**		**5,934,774**
Zhvlerësimi i kërkesave të arkëtueshme	(101,084)		(101,084)
Shpenzimet e shitjes dhe administrative	(3,461,145)	(363,334)	(3,824,478)
Shpenzime të tjera	(61,576)		(61,576)
Fitimi operativ, neto	**1,947,635**		**1,947,636**

4. Zbatimi i standardeve dhe interpretimeve të reja ose të rishikuara

Standartet e reja dhe interpretimet e mëposhtme janë efektive për Shoqërinë nga 1 Janar 2014:

"Kompensimi i Aktiveve Financiare dhe Detyrimeve Financiare" – Ndryshime ndaj SNK 32 (lëshuar në dhjetor 2011 dhe efektiv për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2014). Ndryshimi shtoi udhëzime për aplikimin e SNK 32 i cili trajtonte mungesën e konsistencës të identifikuar gjatë aplikimit të kritereve te kompensimit. Kjo përfshin sqarimin e konceptit "ka një të drejtë të detyruar me ligj për kompensim" dhe që disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohen si ekuvalente të shlyerjeve neto. Standardi përcakton se njsë e drejtë për komensim (a) nuk duhet të kushtëzohet nga ngjarje në të ardhmen dhe (b) duhet të jetë i detyrueshëm me ligj në të gjitha rrethanat në vijim: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast likuidimi dhe falimentimi. Standarti i ndryshuar nuk ka patur ndikim material mbi Shoqërinë.

"Ndryshime ndaj SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27 – Investuesit" – (lëshuar me 31 tetor 2012 dhe efektive për periudhat vjetore që nisin në 1 janar 2014). Ndryshimet prezantuan përkufizimin e një entiteti investues si një entitet që (i) mbledh fonde nga investitorë me qellimin që ti ofroje atyre shërbime drejtimi për investime, (ii) i dedikohet investitorëve me qëllimin që fondet e investuara synojne të rrisin kapitalin apo të sjellin fitime dhe (iii) mat dhe vlerëson investimet e veta duke u bazuar në vlerën e drejtë. Një entiteti investues i kërkohet të japë llogari vetëm për degët e varura në vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së fitimit apo humbjes, si dhe të konsolidoje vetëm ato degë të cilat japin shërbime që janë të lidhura me aktivitetet investuese të entitetit. SNRF 12 u ndryshua duke prezantuar dhënien e informacionit, përfshirë edhe gjykime të rëndësishme të bëra me qellimin për të vlerësuar nëse një entitet është një entitet investues dhe informacionin për mbështetjen financiare ndër të tjera ndaj një dege të pakonsoliduar, nëse mendohet ti jepet kjo mbështetje ose kjo mbështetje është dhënë. Ky standard i ndryshuar nuk pati asnjë efekt për Shoqërinë.

KIFRN 21 – "Taksat" (lëshuar ne 20 maj 2013 dhe efektiv për periudhat vjetore nga 1 janar 2014). Interpretimi sqaron kontabilizimin e në detyrimi për të paguar një taksë apo tatim ndryshe nga tatim fitimi. Ky detyrim lind nga një ndryshim në legjislacion që sjell detyrimin për të paguarën apo tatimin. Fakti që një njësi do të vijojë aktivitetin në periudhat në vijim, osë qe përgatit pasqyrat financiare duke u bazuar në parimin e vijimësisë, nuk krijon një detyrim. Ky parim i njohjes aplikohet në pasqyrat financiare të ndërmjetshme apo vjetore. Aplikimi i interpretit për detyrimet që rrjedhin nga skemat e tregtimit të emisioneve është opsionale. Interpretimi nuk ka patur ndikim material mbi Shoqërinë.

Ndryshime ndaj SNK 36 – "Dhënia e informacionit mbi shumat e rikuperueshme për aktivet jo-financiare" (e lëshuar në maj 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që nisin më 1 janar 2014; aplikimi i mëparshëm ishte i lejuar nëse SNK 13 ishte aplikuar për të njëjtin kontabilizimin, për të njëjtën periudhe krahasuese). Ndryshimet heqin kërkesën për dhënie informacioni për shumën e rikuperueshme kur një njësi gjeneruese e mjeteve monetare ka emër të mire ose për aktive jo-materiale me jetë të papërcaktuar por të cilat nuk ka pasur zhvlerësime. Ky standard i ndryshuar nuk pati asnjë efekt për Shoqërinë.

Ndryshimet në SNK 39 - "Rinovimi i Derivateve dhe Vazhdimi i Kontabilitetit të Mbrojtjes" (lëshuar në qershor 2013 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë pas 1 janar 2014). Ndryshimet lejojnë që kontabilitetin mbrojtës të vazhdojë në një situatë ku një derivat , i cili ka qenë i caktuar si një instrument mbrojeje, rinovohet (pra, palët kanë rënë dakord për të zëvendësuar kundërpartinë origjinale me një të re) për të kryer anulimin me kundërparti kryesore si rezultat i ligjeve apo rregullimeve, nëse janë plotësuar disa kushte specifike. Standarti i ndryshuar nuk ka patur ndikim material mbi Shoqërinë.

5. Standarde të reja

Disa standarte dhe interpretime janë lëshuar të cilat të cilat janë të detyrueshme për periudhat që fillojnë në ose pas 1 janar 2015 , të cilat Shoqëria ende nuk i ka aplikuar.

SNRF 9, "Instrumentet financiare: Sqarime dhe Matja"(ndryshuar në korrik 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2018). Pikat kryesore të standardit janë:

- Aktivet financiare duhet të klasifikohen në tre kategori matjeje: aktive të matura me kosto të amortizueshme, ative të matura me vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse, dhe ato të matura me vlerën e drejte në fitimit apo humbje.

- Sqarimi i intrumenteve të huasë bazohet nga modeli i biznesit së njësisë në manaxhimin e aktiveve financiare dhe sipas faktin nësee flukset monetare kontraktuale rrjedhin krysisht nga pagesat e interesit dhe primit. Nëse një instrument huaje është mbajtur për mbledhje, mund të mbartet me kosto të amortizuar nëse plotëson kushtet e pagesave të primit dhe interesave. Instrumentat e huasë që përmbushin këto kushte mbahen në një portofol ku një njësi mban dhe mbledh flukset monetare nga aktive dhe shet aktive që mund të klasifikohen si vlerë e drejtë mbas fitimit apo humbjes. Aktivet financiare që nuk përmbajnë pagesa për interesa apo prime duhet të maten me vlerën e drejtë në fitim apo humbje (për shembuli, derivativë). Derivatet e përfshira nuk janë më të ndara nga aktivet financiare por do të përfshihen në vlerësimin e kushteve të pagesave të primit dhe interesave.

- Investimet në instrumentet kapitale maten gjithmonë me vlerë të drejtë. Manaxhimi i shoqërisë mund zgjedhë të paraqisë ndryshimet në vlerën e drejtë në të ardhura të tjera përmbledhëse, me kusht që isntrumenti mos të mbahet për qëllime tregtimi. Nëse instrumenti i kapitalit mbahet për qëllime tregtimi, ndryshimet në vlerën e drejtë prezantohen në fitim apo humbje.

- Shumica e kërkesave të SNK 39 ër klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare janë mbartur të pandryshuara sipas SNRF 9. Ndryshimi kryesor është që njësia duhet të paraqesë efektet e ndryshimeve në riskun e kreditit të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në të ardhura përmbledhëse.

- SNRF 9 prezanton një model të ri të njohjes së humbjeve së zhvlerësimit – modelin e humbjeve të pritura të kreditit. Ka një qasje me tre faza e cila bazohet në ndryshimin e cilësisë së kreditit të aktivit financiar që nga njohja. Në praktikë, rregullat e reja parashikojnë që njësitë duhet të njohin një humbje direkte të barabarte humbjet e pritura të kreditit për 12 muaj në njohen fillestare të aktiveve financiare që nuk preken nga zhvlerësimi i kreditit (apo modeli i përhershëm i humbjeve të pritura të kreditit për llogaritë e arkëtueshme). Kur ka një rritje domethënëse në riskun e kreditit, zhvlerësimi matet me modelin e përhershëm në vend të modelit 12 muajsh. Ky model përfshin lehtesira operacionale për qeranë dhe llogaritë e arkëtueshme.

- Kërkesat e kontabilitetit mbrojtës janë amenduar që të përshtatin më shumë kontabilitetin me manaxhimin e riskut. Standardi i jep njësive mundësi zgjedhje mes aplikimit e kërkesave të kontabilitetit të mbrojtes të SNRF 9 apo me aplikimin e SNK 29 sepse standardi momentalisht nuk adreson kontabilitetin makro të mbrojtjes.

Qartësim në lidhje me metodat e lejueshme të amortizimit – Ndryshime në SNK 16 dhe SNK 38 (të publikuara më 12 maj 2014 dhe efektive për periudhat që fillojnë më 1 janar 2016). Me këtë ndryshim, BSNK ka qartësuar që përdorimi e metodave të bazuara në të ardhura për përllogaritjen e amortizimit të një aktivi nuk është i përshtatshëm duke qenë se të ardhurat e gjeneruara nga aktiviteti që përfshin përdorimin e aktivit pasqyron zakonisht faktorë që nuk kanë të bëjnë me konsumimin e përfitimeve ekonomike të lidhura me aktivin.

5. Standarde të reja (vazhdim)

SNRF 15, Të ardhurat nga Kontratat me Klientët (lëshuar më 28 maj 2014 dhe efektiv për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janar 2017). Standardi i ri prezanton parimin bazë se të ardhurat duhet të njihen kur mallrat ose shërbimet janë transferuar tek klientët, me çmimin e transaksionit. Çfarëdo mallra apo shërbime të paketuara të cilat janë të dallueshme duhet të njihet veçmas, dhe uljet apo zbritjet e çmimit duhet të ndahen për elementevet përkatëse. Kur konsiderata ndryshon për ndonjë arsye, duhet të njihet një shumë minimale nëse nuk ke një risk domethënës për kthim. Shpenzimet e kryera për të siguruar kontrata me klientët duhet të kapitalizohen dhe amortizohen gjatë periudhës kur konsumohen përfitimet e kontratës.

ShoqërShoqëria po vlerëson aktualisht efektin e standarteve të reja mbi pasqyrat e saj financiare, në veçanti efektin e SNRF 15 i cili pritet të ketë ndikim të madh mbi mënyrën e njohjes së të ardhurave për disa prej linjave të të ardhurave dhe modelit te biznesit të Shoqërisë.

Standartet dhe publikimet e mëposhtme nuk pritet te kenë efekt të madh mbi shoqërinë kur të aplikohen:

- Ndryshimet në SNK 19 - "Kontributet e punonjësve" (publikuar në nëntor 2013 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 korrik 2014).
- Përmirësimet vjetore te SNRF-ve 2012 (të lëshuara në Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Korrik 2014)
- Përmirësimet vjetore te SNRF-ve 2013 (të lëshuara në Dhjetor 2013 dhe efektive per periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Korrik 2014)
- SNRF 14, Llogaritë e shtyra (lëshuar në janar 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 janar 2016).
- Kontabilizimi për Blerjet e Interesave në Operacionet e Përbashkëta – Amendime te SNRF 11 (të lëshuara më 6 Maj 2014 dhe efektive per periudha vjetore duke filluar nga 1 Janar 2016)
- Bujqësi: Bimë rritësit - Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 41 (publikuar me 30 qershor 2014 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2016)
- Metoda kapitale në Pasqyra Financiare të veçanta – Amendime të ISA 27 (të lëshuara më 12 Gusht 2014 dhe efektive per periudha vjetore duke filluar nga 1 Janar 2016)
- Shitja apo Kontributi i aktiveve mes një investitori dhe bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrje të përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të lëshuar më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).
- Përmirësimet vjetore për SNRF-të 2014 (publikuar më 25 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2016).

Përveç rasteve të specifikuara ndryshe më sipër, nuk pritet të ketë ndonjë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat e shoqërisë në sajë të standardeve dhe interpretimeve të mësipërme.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar

Funksioni i menaxhimit të rrezikut brenda shoqërisë kryhet në lidhje me rreziqet financiare, operacionale dhe ligjore. Rreziku financiar përfshin rrezikun e tregut (duke përfshirë rrezikun e monedhës, të normës së interesit dhe atë nga çmimet e tjera), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit.

Ky shënim shpjegues paraqet informacion në lidhje me ekspozimin e shoqërisë ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme si dhe objektivat, politikat dhe proceset e saj për matjen dhe menaxhimin e rrezikut dhe kapitalit të shoqërisë. Shpjegime të tjera sasiore janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare dhe veçanërisht në shënimin 26.

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësinë e përgjithshme të krijimit dhe mbikëqyrjes së kuadrit të menaxhimit të rrezikut të shoqërisë. Politikat e shoqërisë për menaxhimin e rrezikut janë ndërtuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet me të cilat përballet shoqëria, për të vendosur kontrolle dhe limite ndaj rrezikut dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, përmes standardeve të trajnimit dhe të menaxhimit, synon të krijojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre.

Komiteti i Auditimit te Grupit OTE ("Grupi') mbikëqyr se si drejtimi monitoron përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e Grupit dhe shoqërisë për menaxhimin e rrezikut dhe rishikon përshtatshmërinë e kuadrit të menaxhimit të rrezikut në lidhje me rreziqet me të cilat përballet shoqëria.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Instrumentet kryesore financiare të shoqërisë përbëhen nga mjetet monetare në arkë dhe bankë, kredi ndaj palëve të lidhura, llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme, të drejtat dhe detyrimet e tjera.

a) Rreziku i kreditimit
Rreziku i kreditimit është rreziku që njëra palë në një instrument financiar të shkaktojë humbje financiare për palën tjetër duke dështuar në shlyerjen e një detyrimi. Për shkak të vëllimit të madh dhe shumëllojshmërisë së bazës konsumatore të shoqërisë, përqendrimet e rrezikut të kredisë në lidhje me llogaritë e arkëtueshme nga abonentët janë të kufizuara. Provigjonet për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta caktohen në shumën që konsiderohet e nevojshme për të mbuluar rreziqet potenciale në arkëtimin e gjendjeve të llogarive të arkëtueshme.

Shoqëria ka investime financiare te rendesishme të mbajtura deri ne maturim që kanë të bëjnë me obligacione të emetuara nga OTE plc, një shoqëri e lidhur me AMC, për të cilën nuk është identifikuar rreziku i mos-arkëtueshmërisë.

b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që shoqëria të ketë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare. Shoqëria ka ekspozim kundrejt kërkesave për burime monetare. Rreziku menaxhohet nga Departamenti i Thesarit të shoqërisë përmes monitorimit të parashikimeve mujore të flukseve të parasë. Megjithatë, shoqëria arrin të gjenerojë fluske të rëndësishme monetare nga aktivitetet operacionale saqë ajo është e mendimit që rreziku i likuiditetit të saj është i papërfillshëm.

c) Rreziku i Tregut

(i) Rreziku i normave të interesit
Shoqëria ekspozohet ndaj efekteve të ndryshimeve në normat bazë të interesit kundrejt pozicionit të saj financiar dhe flukseve të parasë. Për rrezikun e normave të interesit ndaj të cilit është e ekspozuar shoqëria, referojuni shënimit 26.

(ii) Rreziku i kurseve të këmbimit
Shoqëria ka disa instrumenta financiare të mbatjura në Euro, si për shembull obligacione nga OTE plc, depozita ne Euro me bankat dhe llogari të pagueshme afatshkurtra në Euro me furnitorët e aktiveve afatgjata më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013, të cilat e ekspozojnë atë ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit. Drejtimi nuk ka investuar në instrumente mbrojtës për t'u mbrojtur ndaj këtij rreziku.

d) Analiza e ndjeshmërisë

Me anë të menaxhimit të rrezikut të normave të interesit dhe kurseve të këmbimit, shoqëria synon të reduktojë impaktin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e shoqërisë. Gjithsesi, në periudhën afatgjatë ndryshimet e përhershme në kurset e këmbimit dhe normat e interesit mund të kenë një ndikim në fitim. Efekti që mund të ketë një ndryshim në përqindjen e normave të interesit ose në vlerën e Lekut kundrejt monedhave të tjera më 31 Dhjetor 2014 dhe 2013, paraqitet në shënimin 26.

(e) Menaxhimi i kapitalit
Politika e shoqërisë është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besimin e investitorëve, kreditorëve dhe tregut, dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Bordi i Drejtorëve monitoron kthimin ndaj kapitalin, të cilin shoqëria e përcakton si fitimi para tatimit pjesëtuar me kapitalin aksionar. Bordi i Drejtorëve monitoron gjithashtu edhe nivelin e dividendëve ndaj aksionarëve të zakonshëm.

Shoqëria ka arritur një kthim mbi kapitalin prej 3,98% ne vitin 2014 (2013: 6.21 %).

Shoqëria nuk është subjekt i kërkesave të jashtme për nivelin e kapitalit.

Nuk ka pasur ndryshime gjatë vitit në trajtimin e menaxhimit të rrezikut financiar dhe menaxhimit të kapitalit nga ana e shoqërisë.

7. Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit

	2014	2013
Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit		
Të ardhura nga shërbimet me parapagim dhe kontratë	5,847,849	6,873,410
Të ardhura nga interkonjeksioni	4,993,927	4,888,992
Të ardhura nga roaming	213,060	231,552
Të ardhura të tjera operative	215,221	209,618
	11,270,057	12,203,572
Të ardhura nga shitja e aparateve dhe aksesorëve	141,604	246,422
	11,411,661	12,449,994

8. Kosto e shërbimeve të realizuara

	2014	2013
Amortizimi (shënimi 11 dhe 12)	2,543,977	2,656,666
Shpenzime interkonjeksioni	1,979,396	1,403,869
Riparime dhe mirëmbajtje	787,926	753,974
Shpenzime komunale	341,693	325,537
Shpenzime personeli	251,345	282,416
Shpenzime qiraje	210,243	225,882
Tarifa "roaming" nga operatorë të rrjeteve ndërkombëtare	111,091	138,007
Shepnzime për sigurinë e rrjetit	104,380	102,584
Shpenzime për kartat e parapaguara dhe kartave SIM	17,346	44,117
Linja të marra me qira	38,082	39,478
Të tjera	229,271	251,923
	6,614,750	6,224,453

Kosto e mallrave të shitura në vitin 2014 përfshin një shumë prej 2,280 mijë Lekë provigjon për inventarin e vjetër dhe atë të dëmtuar. Përveç kësaj, shoqëria ka realizuar shitje promocionale të stokut me lëvizje të ngadaltë dhe në rastet e produkteve shumë të vjetra, ulja e ofruar sillte shitje nën kosto të materialeve me qëllim pastrimin e cilësisë së inventarizuar dhe lirimin e fondeve të bllokuara si dhe tërheqjen e klientëve në rrjetin e shitjes duke ofruar produkte shtesë ose kombinime produktesh.

9. Shpenzimet e shitjes, të përgjithshme dhe administrative

	2014	2013
Shpenzime reklamash	881,309	1,213,543
Shpenzime konsulence dhe tarifa të tjera	856,888	811,697
Shpenzime personeli	726,144	679,435
Komisione Distributoreve	434,500	624,434
Amortizimi (shënimi 11 dhe 12)	125,895	128,719
Shpenzime komunale	56,406	65,347
Shpenzime qiraje	52,304	49,442
Riparime dhe mirëmbajtje	41,313	43,690
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	10,350	15,081
Shpenzime të tjera administrative	120,057	193,090
	3,305,166	3,824,478

10. Shpenzime tatim fitimi

Provigjoni për tatim fitimin është analizuar si vijon:

	2014	2013
Tatim fitimi i vitit aktual	479,565	562,459
Tatim fitimi i shtyre (shënimi 13)	5,470	(262,394)
	485,035	**300,065**

Në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2014 është 15% (2013: 10%). Rakordimi i shpenzimit për tatimin mbi fitimin me shumën e përcaktuar nga zbatimi i normës tatimore mbi fitimin në Shqipëri, është përmbledhur si në vijim:

	%	2014	%	2013
Fitimi para tatimit		**2,928,089**		**4,423,985**
Tatimi mbi fitimin duke përdorur normën vendase te tatimit mbi fitimin	15.00%	439,213	10.00%	442,399
Efekte tatimore te Shpenzime të pazbritshme dhe rregullime për të ardhurat e tatueshme	1.38%	40,352	2.71%	120,060
	16.38%	**479,565**	**12.71%**	**562,459**

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por fitimet apo humbjet e deklaruara për qëllime tatimore qëndrojnë provizore për aq kohë sa autoritet tatimore kontrollojnë deklaratat dhe regjistrimet kontabël të taksapaguesit dhe dorëzojnë një vlerësim final. Ligjislacioni dhe rregulloret/udhëzimet tatimore janë subjekt i interpretimeve nga autoritet tatimore.

Periudhat fiskale janë subjekt kontrolli nga autoritetet tatimore deri në pesë vite kalendarike që paraprijnë vitin për të cilin kryhet kontrolli. Në disa situata, kontrollet mund të mbulojnë periudha më të gjata kohore.

Lëvizjet në tatim fitimin e arkëtueshëm për vitet 2014 dhe 2013 paraqiten si në vijim:

	2014	2013
Çelje	493,072	510,900
Parapagime tatim fitimi	649,047	529,381
Kompensime	13,287	15,250
Shpenzimi i tatim fitimit gjatë periudhës	(479,565)	(562,459)
	675,841	**493,072**

11. Aktive afatgjata materiale

	Aktive administrative	Ndërtesa rrjeti	Sisteme dhe instalime telekomunikacioni	Punime në proçes	Total
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2013	**2,982,737**	**7,950,564**	**29,117,793**	**1,600,277**	**41,651,371**
Shtesa	74,430	54,636	327,240	929,333	1,385,639
Blerje nga palët e lidhura (shënimi 27)	6,562	-	-	4,839	11,401
Pakësime	(35,527)	(7,060)	(84,273)	-	(126,860)
Transferime nga aktivet në proçes	843	43,936	1,233,303	(1,278,082)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**3,029,045**	**8,042,076**	**30,594,063**	**1,256,367**	**42,921,551**
Gjendja më 1 janar 2014	**3,029,045**	**8,042,076**	**30,594,063**	**1,256,367**	**42,921,551**
Shtesa	59,808	42,149	894,700	276,071	1,272,728
Blerje nga palët e lidhura	4,084	-	-	-	4,084
Pakësime	(92,155)	(4,057)	(10,885)	-	(107,097)
Transferime nga aktivet në proçes	17	22,410	682,840	(705,267)	-
Riklasifikime	(117,545)	(77,086)	194,631	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**2,883,254**	**8,025,492**	**32,355,349**	**827,171**	**44,091,266**
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2013	**1,812,582**	**6,154,311**	**21,463,729**	**-**	**29,430,622**
Shpenzimi i vitit	218,534	355,074	1,900,167	-	2,473,775
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 27)	1,071	-	-	-	1,071
Pakësime	(30,254)	(6,959)	(67,635)	-	(104,848)
Riklasifikime	(15,372)	6,751	8,621	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**1,986,561**	**6,509,177**	**23,304,882**	**-**	**31,800,620**
Gjendja më 1 janar 2014	**1,986,561**	**6,509,177**	**23,304,882**	**-**	**31,800,620**
Shpenzimi i vitit	185,162	319,155	1,861,982	-	2,366,299
Blerjet nga palët e lidhura (shënimi 27)	763	-	-	-	763
Pakësime	(74,703)	(456)	(8,732)	-	(83,891)
Riklasifikime	(103,081)	(54,064)	157,145	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**1,994,702**	**6,773,812**	**25,315,277**		**34,083,791**
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2013	**1,042,484**	**1,532,899**	**7,289,181**	**1,256,367**	**11,120,931**
Më 31 dhjetor 2014	**888,552**	**1,251,680**	**7,040,072**	**827,171**	**10,007,475**

11. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Zhvlerësime dhe rimarrje të mëvonshme

Shoqëria vlerëson në mënyrë të vazhdueshme përmirësimet teknologjike dhe progresin e aktiveve materiale duke rishikuar gjithashtu funksionet dhe përshtatshmërinë e tyre me infrastrukturën ekzistuese. Në rast se ndodhin dëmtime ose nxjerrje jashtë përdorimit, atëherë kryhet një testim zhvlerësimi dhe aktivi zhvlerësohet ose shitet.

Aktive në proçes

Aktivet në proçes lidhen kryesisht me pajisje, të cilat duhet të shpërndahen në stacione antenash të ndryshme në zbatim të planit të shoqërisë si dhe me punime në proçes të cilat konsistojnë kryesisht në ndërtimin e ndërtesave ose stacioneve për antena. Më 31 dhjetor 2014 një pjesë e konsiderueshme e punimeve në proces përbëhet pajisje telekomunikacioni të painstaluara.

Çështje të tjera

Asnjë prej aktiveve të shoqërisë nuk është përdorur si kolateral. Gjatë vitit aktual si dhe viteve të mëparshme, shoqëria nuk ka marrë hua për investime, si rrjedhojë, në koston e aktiveve afatgjata materiale nuk janë përfshirë interesa. Gjithashtu nuk ka aktive afatgjata materiale të blera me qira financiare.

Riklasifikimet lidhen me ndryshime në politikat kontabël dhe sistemet e kontabilitetit të Grupit të cilat herë pas here kanë nevojë për ndryshime në klasifikime midis kategorive të ndryshme. Këto cilësohen si ndryshime në vlerësimet kontabël.

12. Aktivet afatgjata jomateriale

	Liçenca 3G	Liçenca	Programe kompjuterike	Aktive në proçes	Totali
Kosto					
Gjendja më 1 janar 2013	**2,121,399**	**85,182**	**830,510**	**145,115**	**3,182,206**
Shtesa	-	-	9,020	82,700	91,720
Transferime	-	73,309	146,580	(219,889)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**2,121,399**	**158,491**	**986,110**	**7,926**	**3,273,926**
Gjendja më 1 janar 2014	**2,121,399**	**158,491**	**986,110**	**7,926**	**3,273,926**
Shtesa	-	-	85,052	-	85,052
Transferime	-	7,926	-	(7,926)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**2,121,399**	**166,417**	**1,071,162**	**-**	**3,358,978**
Amortizimi i akumuluar					
Gjendja më 1 janar 2013	**178,246**	**34,471**	**584,743**	**-**	**797,460**
Shpenzimi i vitit	141,434	18,254	150,851	-	310,539
Gjendja më 31 dhjetor 2013	**319,680**	**52,725**	**735,594**	**-**	**1,107,999**
Gjendja më 1 janar 2014	**319,680**	**52,725**	**735,594**	**-**	**1,107,999**
Shpenzimi i vitit	141,434	23,207	138,169	-	302,810
Gjendja më 31 dhjetor 2014	**461,114**	**75,932**	**873,763**	**-**	**1,410,809**
Vlera kontabël neto					
Më 31 Dhjetor 2013	**1,801,719**	**105,766**	**250,516**	**7,926**	**2,165,927**
Më 31 Dhjetor 2014	**1,660,285**	**90,485**	**197,399**	**-**	**1,948,169**

13. Tatim fitimi i shtyrë

Aktivet dhe pasivet për tatimet e shtyra i përkasin zërave të mëposhtme:

	2014	2013
Aktive afatgjata materiale	722,039	702,236
Liçenca	(40,763)	(14,944)
Të ardhura të shtyra nga koha e bisedës	84,675	96,767
Të ardhura nga Interkonjeksioni	(34,830)	(34,830)
Të tjera, neto	(12,310)	(24,948)
	718,811	**724,281**

Norma e zbatuar e tatimit për qëllime të llogaritjes së tatimit të shtyre është 15%, e cila është norma e tatim-fitimit që ka hyrë në fuqi më 31 dhjetor 2013 dhe efektive prej datës 1 Janar 2014 (2013: 15%).

Të gjitha lëvizjet në gjendjen e tatimit të shtyrë janë njohur në fitim/humbje.

	Gjendja më 1 Janar 2013	E njohur në fitim/ humbje	Gjendja më 31 Dhjetor 2013	E njohur në fitim/ humbje	Gjendja më 31 Dhjetor 2014
Aktive afatgjata materiale	422,585	279,651	702,236	19,803	722,039
Licenca	18,843	(33,787)	(14,944)	(25,819)	(40,763)
Të ardhura të shtyra nga koha e bisedës	68,474	28,293	96,767	(12,092)	84,675
Interkonjeksioni	(23,220)	(11,610)	(34,830)		(34,830)
Të tjera	(24,795)	(153)	(24,948)	12,638	(12,310)
	461,887	**262,394**	**724,281**	**(5,470)**	**718,811**

14. Inventari

	2014	2013
Aparate dhe aksesorë	202,259	261,307
Kancelari dhe të tjera të konsumueshme	134,313	139,959
Karta SIM	17,558	36,402
Provigjone	(2,950)	(26,623)
	351,180	**411,045**

Përveç shumës së regjistruar si kosto e shitjes së aparateve dhe aksesorëve, aparatet dhe aksesorët të cilat i janë ofruar klientëve për mbajtje ose shitje janë regjistruar si shpenzim shpërndarje dhe shitjeje në pasqyrën e fitimit ose humbjes për periudhën dhe kosto e shitjes arrin shumën 121,126 mijë Lekë (2013: 188,931 mijë Lekë).

15. Llogaritë e arkëtueshme

	2014	2013
Afatgjata		
Operatorë ndërkombëtarë të interkonjeksionit	73,063	84,952
	73,063	**84,952**
Afatshkurtra		
Klientë për shërbimet e ofruara	1,562,812	2,630,241
Operatorët kombëtarë të interkonjeksionit	1,074,544	1,053,528
Operatorët ndërkombëtarë të rrjetit GSM për shërbimet Roaming	201,473	324,701
Operatorët ndërkombëtarë të interkonjeksionit	144,677	319,935
Të ardhura nga distributorët	109,972	226,445
Të tjera	54,320	37,716
	3,147,798	**4,592,566**
Minus: Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(1,930,129)	(3,023,411)
	1,217,669	**1,569,155**
	1,290,732	**1,654,107**

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të monedhës dhe humbjeve nga zhvlerësimi në lidhje me llogaritë e arkëtueshme, paraqitet në shënimin 24.

Llogaritë e arkëtueshme nga distributorët përfshijnë të drejta të arkëtueshme nga shitja e kartave dhe aksesorëve tek distributorët e shoqërisë.

16. Aktive të tjera

Aktivet e tjera afatgjata analizohen si më poshtë:

	2014	2013
Hua të dhëna punonjësve	11,104	8,888
Shpenzime të parapaguara	18,098	442
Të drejta të tjera nga autoritetet tatimore	-	2,576
Shpenzime të parapaguara për rrjetet e marra me qira (afatgjata)	167,497	-
	196,699	**11,906**

Aktivet e tjera afatshkurtra analizohen si më poshtë:

	2014	2013
Tatime të parapaguara, përveç tatim fitimit	865,554	848,312
Shpenzime të parapaguara	281,843	317,351
Të tjera	69,661	52,393
	1,217,058	**1,218,056**

Shoqëria ka depozituar një shumë prej 237,872 mijë Lekë (2013: 220,216 mijë Lekë) të vendosura si garanci për çështje gjyqësore në proçes, prej të cilave 219,773 mijë Lekë janë klasifikuar si aktive të tjera afatshkurtra (në shpenzime të parapaguara).

17. Mjete monetare

	2014	2013
Mjete monetare në arkë	1,969	1,922
Mjete monetare në bankë		
Llogari rrjedhëse në Lekë	498,166	1,798,686
Llogari rrjedhëse në monedhë të huaj	4,965,441	5,582,636
Depozita afatshkurtra në Lekë	150,000	700,000
Depozita afatshkurtra në monedhë të huaj	560,773	1,404,175
	6,174,380	9,485,497
Mjete monetare	6,176,349	9,487,419

Norma mesatare e interesit e fituar nga depozitat gjatë vitit 2014 ishte 2.96% në Lekë, 0.98% në Euro dhe zero në Dollarë Amerikan (2013: 3.58% në Lekë, 1.44 % në Euro, zero % në Dollarë).

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të normës së interesit dhe analiza e ndjeshmërisë për aktivet financiare dhe detyrimet paraqiten në shënimin 26.

Shoqëria ka depozituar një shumë prej 237,872 mijë Lekë (2013: 220,216 mijë Lekë) të vendosura si garanci për çështje gjyqësore në proces. Shuma prej 18,098 mijë Lekë (2013: 442 mijë Lekë) nga balanca e garancisë për çështje gjyqësore është klasifikuar në aktivet afatgjata (shpenzimet e parapaguara, shënimi 16).

18. Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve

Mbajtësit e aksioneve të zakonshme gëzojnë të drejtën të marrin dividendin nëse ai deklarohet herë pas here, dhe kanë gjithashtu të drejtën e një vote për çdo aksion në mbledhjet e aksionarëve të shoqërisë. Ashtu si më 31 dhjetor 2014 dhe 2013, kapitali themeltar i shoqërisë arriti në shumën 813,822 mijë aksione të zakonshme me vlerë nominale prej 1,000 Lekë secili. Kapitali themeltar i autorizuar është paguar plotësisht.

Në muajin prill të vitit 2007, Asambleja e Përgjithshme aprovoi një plan opsioni aksionesh për t'ua ofruar drejtorëve ekzekutivë të shoqërisë dhe shoqërive të lidhura. Në vijim të këtij vendimi, në muajin dhjetor të vitit 2007, Bordi Drejtues u dha të drejta për opsione punonjësve që plotësojnë kriteret.

Asambleja e Përgjithshme e OTE-së aprovoi me 9 korrik 2008 disa modifikime të planeve të opsioneve të aksioneve të grupit të shoqërive të OTE-së Cosmote-së dhe emetoi një plan të ri opsionesh për aksione për vitet 2008 deri 2010.

Një modifikim tjetër i këtyre planeve u aprovua nga Asambleja e Përgjithshme e OTE më 10 korrik 2009. Ky modifikim do të zgjaste periudhën ushtrimore me dy vjet për të gjitha planet aktive të opsioneve për aksione dhe do të lejonte ushtrimin e opsioneve përmes aksioneve të veta.

Duke marrë parasysh rezolutat e mësipërme, Bordi i Drejtorëve mori vendim emetimin e planit të opsioneve të vitit 2010 (grupi i tretë). Numri i opsioneve të ofruara për çdo pjesëmarrës u finalizua dhe komunikua më 9 shtator 2011.

Planet e opsioneve për aksione u jepen punonjësve si pjesë e paketës së tyre të shpërblimit, kryesisht në formë bonusi.

Më 31 dhjetor 2014, tre plane opsionesh ishin aktive për aksione (nga viti 2009 deri 2011), çmimi i ekzekutimit të të cilëve varionte nga 4.23 Euro deri në 19.49 Euro.

Lloji i planit: Plani i opsioneve për aksioneve i ofrohet stafit të lartë drejtues të OTE-së dhe shoqërive të lidhura (filialeve).

18. Kapitali aksionar dhe primi i aksioneve (vazhdim)

Çmimi i ushtruar: Çmimi preferencial minus një zbritje që varet nga EBITDA e grupit OTE dhe OTE SA në datën e ushtrimit.

Zbritja varion nga 0% deri në 20% për stafin e mesëm drejtues dhe nga 0% deri në 25% për drejtuesit e lartë.

Çmimi preferencial:
- Plani i vitit 2010: 5.64 Euro
- Plani i vitit 2009: 11.26 Euro
- Plani i vitit 2008: 19.49 Euro

Kushtet e ushtrimit: Një vlerësim personal të paktën në nivelin "shumë mirë" duke i shtuar dhe kushtet e mëposhtme të shërbimit:

- Opsionet Bazë:
- 40% e opsioneve: 1 vit
- 30% e opsioneve: 2 vjet
- 30% e opsioneve: 3 vjet
- Opsione Shtesë: 3 vite shërbim

Datat e ushtrimit: Në muajt Prill dhe Tetor të secilit vit që pason datën e ushtrimit dhe deri në Tetor të:
- Planit të vitit 2010: 2016
- Planit të vitit 2009: 2015
- Planit të vitit 2008: 2014

Në bazë të këtij vlerësimiopsionet përfunduan në 31 dhjetor 2014. Asnjë opsion nuk u dha apo ushtrua gjatë periudhës.

Lëvizje në numrin e opsioneve	Numri i opsioneve	
	2014	2013
Të pa ushtruara në fillim të periudhës:	21,850	29,440
Të dhëna gjatë periudhës	-	-
Të humbura/anuluara	-	(7,590)
Të ushtruara gjatë periudhës	-	-
Të përfunduara në fund të periudhës	(21,850)	-
Të pa ushtruara në fund të periudhës	-	21,850
Të ushtruara në fund të periudhës	-	**21,850**

Shpenzimet e njohura si fitim ose humbje
Vlera e shërbimeve të marra nga punonjësit llogaritet duke iu referuar vlerës së drejtë të instrumenteve të dhëna të kapitalit. Vlera e drejtë e shërbimeve të marra njihet si shpenzim për shpërblim dhe i korrespondon një rritjeje në kapitalin aksionar. Modifikimet e bëra në planin e opsioneve të aksioneve që rritën vlerën e drejtë të instrumenteve të kapitalit aksionar janë përfshirë në shpenzimet për shpërblime që nga data e modifikimit.

Shpenzimi njihet në mënyrë të njëtrajtshme gjatë periudhës së ushtrimit të opsioneve duke marrë në konsideratë numrin e opsioneve që priten të ushtrohen dhe rregullohet për të reflektuar rezultatin real të kushteve që nuk kanë lidhje me tregun.

Shoqëria ka rregulluar shpenzimin kumulativ të shpërblimit dhe njohu shpenzimin prej zero Lekë për vitin 2014 (të ardhura prej 2,881 mijë Lekë për vitin 2013).

19. Rezervat

	2014	2013
Rezerva ligjore	81,382	81,382
Rezerva e zhvillimit	23,595,635	23,595,635
	23,677,017	23,677,017

Rezerva Ligjore
Në zbatim të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", shoqërive u kërkohet që të transferojnë një minimum prej pesë përqind të fitimit të tyre vjetor neto pas tatimeve siç paraqitet në librat e tyre të kontabilitetit, si një rezervë ligjore, derisa kjo rezervë të arrijë vlerën sa 1/10 e kapitalit aksionar. Kjo rezervë nuk mund të shpërndahet.

Rezerva e zhvillimit
Në përputhje me statutin dhe aktin e themelimit të shoqërisë dhe për sa kohë që Qeveria e Republikës së Shqipërisë ishte i vetmi aksionar, shoqërisë i kërkohej të transferonte 85% të fitimeve të saj ligjore neto ne rezervën e zhvillimit. Pas privatizimit të shoqërisë, ky provizion është lënë në dorë të aksionarëve. Sipas statutit të AMC-se nuk ka kufizim për shpërndarjen e rezervës së zhvillimit.

20. Dividendët

Nga fitimet e viteve fiskale 2014 dhe 2013 nuk u shpërnda asnjë dividend. Të gjitha fitimet neto u transferuan në fitimin e mbartur.

21. Fitimi për aksion

Llogaritja e fitimit bazë për aksion më 31 dhjetor 2014 bazohet në fitimin që i përket aksionarëve të zakonshëm në shumën 2,443,054 mijë Lekë (2013: 4,123,920 mijë Lekë) dhe në numrin mesatar të ponderuar të aksioneve të zakonshme gjatë vitit 2014 prej 813,822 (2013: 813,822). Ndërkohë nuk kishte aksione të pakësuara gjatë periudhës dhe periudhave raportuese të mëparshme.

22. Të ardhura e papërfituara

Të ardhurat e papërfituara janë shtyrë përgjatë periudhës së kontratës për qiradhënien e kapaciteteve ose sipas përdorimit në rastin e kohës së papërdorur të bisedës. Kontrata e "IRU" (të drejta përdorimi të pakthyeshme) e cila i ofrohet shoqërisë OTEGLOBE nga AMC sipas kushteve të kontratës janë faturuar në vitin 2008 dhe kontrata për fibrën optike, është faturuar në vitin 2014. Të dyja kontratat janë arkëtuar. AMC ka në kushtet e qirasë, një rrjet telekomunikacioni të fibrës optike në territorin e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjes së Fibrës Optike ndërmjet AMC dhe Albtelekom. Në bazë të marrëveshjes me Oteglobe, AMC nënkontrakton qiranë e fibrës optike në pjesën e rrjetit të Albtelekom të lokalizuar në Shqipëri

Detyrimi për vitet e ardhshme që vjen nga këto kontrata pas vitit 2016, është klasifikuar si detyrim afatgjatë. Kontrata ka një kohëzgjatje prej 15 vitesh.

Të ardhurat e papërfituara për kohën e bisedës të pa konsumuar përbëjnë detyrime afatshkurtra.

	2014	2013
Afatgjatë		
IRU dhe Bandwidth	**338,547**	182,021
Afatshkurtër		
Të ardhura të shtyra për kohën e pakonsumuar të bisedës	564,501	645,110
Të ardhura të papërfituara nga IRU	34,943	20,950
Të ardhura të papërfituara nga kontratat e përfunduara para afatit	179,568	114,973
Të tjera	805	787
	779,818	**781,820**
Totali i të ardhurave të papërfituara	**1,118,364**	**963,841**

23. Provigjonet

Shoqëria ka njohur provigjonet e mëposhtme më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	2014	2013
Afatgjata		
Provigjone për rreziqe fiskale	13,500	13,500
Detyrime për tërheqjen e aktiveve	100,128	94,171
	113,628	**107,671**
Afatshkurtra		
Autoriteti i Konkurrencës		211,552
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	45,293	60,379
	45,293	**271,931**
Totali i provigjoneve	**158,921**	**379,602**

Për më shumë detaje rreth provigjonit për rreziqe fiskale referojuni shënimit 29 (iv) më poshtë.

Provigjonet e tjera përfaqësojnë detyrimet për tërheqjen e aktiveve të përllogaritura në përputhje me SNK 37.

Gjatë veprimtarisë së saj, shoqëria ka marrë me qira prona mbi të cilat ka ndërtuar kullat e transmetimit dhe përforcimit. Shoqëria ka lidhur kontrata të reja qiraje çdo vit dhe në shumicën e rasteve ka të drejtë të rinovojë kushtet fillestare të kontratës së qirasë. Legjislacioni përkatës, i kërkon shoqërisë të çmontojë kullat e transmetimit dhe përforcimit, dhe aty ku është e nevojshme të rehabilitojë vendqëndrimin, në fund të periudhës së qirasë. Shoqëria njeh vlerën e drejtë të detyrimit për tërheqjen e aktiveve/detyrimet për rehabilitimin e vendqëndrimit dhe e kapitalizon këtë kosto si pjesë të kostos së aktivit përkatës duke e amortizuar atë në mënyrë lineare përgjatë jetës së dobishme të aktivit.

Tabela në vijim pasqyron të gjithë ndryshimet në detyrimin e shoqërisë për tërheqjen e aktiveve.

23. Provigjonet (vazhdim)

	2014	2013
Detyrimet për tërheqjen e aktiveve më 1 janar	94,171	90,876
Detyrim i njohur gjatë vitit	2,324	1,397
Rritje e shpenzimit për vitin	3,633	1,898
Detyrimet për tërheqjen e aktiveve në 31 dhjetor	**100,128**	**94,171**

Për shkak të natyrës afatgjatë të detyrimit, pasiguria më e madhe për sa i përket vlerësimit të provigjonit është kostoja që do të nevojitet. Në veçanti, shoqëria ka supozuar se detyrimi për tërheqjen e aktivit/rehabilitimin e vendqëndrimit do të ndodhë duke përdorur teknologjinë dhe materialet e disponueshme në periudhën aktuale.

Supozimet bazë të përdorura në llogaritjen e detyrimit për tërheqjen e aktivit janë si më poshtë:

- Norma e zbritjes për të llogaritur vlerën aktuale: 2.5% (2013 3.69%). Vlera e skontuar është rregulluar edhe duke marrë parasysh normën mesatare të inflacionit: 1% (2013: 1%) dhe faktorin e rrezikut 4 % (2013:4%). Shoqëria ka vlerësuar detyrimin duke përdorur mesataren e këtyre variablave përgjatë 18 viteve (kohëzgjatja mesatare e kontratave).

- Mesatarja e kohëzgjatjes së kontratave bazohet në numrin e stacioneve kryesore për të cilat është firmosur një kontratë qiraje dhe kohëzgjatja respektive e kontratës për secilin stacion.

Kohëzgjatja mesatare e kontratave përditësohet çdo vit sipas listës së stacioneve, vazhdimësisë së kontratave ekzistuese dhe lidhjes së kontratave të reja. Ndërsa, në rastin e kontratave në pritje për rinovim, ajo konsiderohet sikur të kishte të njëjtën kohëzgjatje sa mesatarja e periudhës së kontratave (18 vjet).

Detyrimi ndaj AKEP lidhet me tarifën vjetore të vendosur nga Autoriteti pë shpenzimet e veta administrative e cila mund të llogaritet deri në 0.5% e të ardhurave vjetore të shoqërive të telekomunikacionit e rregulluar me nivelin e pagesës e vendosur nga Autoriteti. Provisoni i vitit 2013 është rimarrë në vitin 2014 duke qënë se shoqëria ka marrë faturën përkatëse.

24. Llogaritë e pagueshme

	2014	2013
Furnitorë për aktive afatgjata	923,875	885,773
Furnitorë të tjerë	775,942	760,504
Furnitorë për inventar	45,909	10,636
Operatorë ndërkombëtarë (roaming dhe interkonjeksion)	240,167	844,940
Operatorë të tjerë telekomunikacioni	161,857	125,758
	2,147,750	**2,627,611**

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të monedhës që lind nga llogaritë e pagueshme paraqitet në shënimin 26.

25. Shpenzime të përllogaritura dhe detyrime të tjera

	2014	2013
Depozitat e klientëve (garancitë)	248,638	228,783
Detyrime ndaj punonjësve	82,273	77,408
Dividendë të pagueshëm	1,075	1,075
Të tjera	111,762	100,710
Detyrime Financiare	***443,748***	***407,976***
Sigurime shoqërore të pagueshme	18,508	15,094
Taksa përveç tatim-fitimit	8,859	29
	471,115	**423,099**

26. Instrumentet financiare

a) Rreziku kreditor

Vlera kontabël e aktiveve financiare përfaqëson ekspozimin maksimal të kredisë si më poshtë:

	2014	2013
Hua ndaj palëve të lidhura (shënimi 27)	54,349,726	48,401,853
Detyrime nga palë të lidhura, interesa të përllogaritur (shënimi 27)	1,109,975	329,009
Llogaritë e arkëtueshme (shënimi 15)	1,290,731	1,654,107
Detyrime nga palë të lidhura (shënimi 27)	817,330	455,069
Mjete monetare (shënimi 17)	6,176,349	9,487,419
	63,744,111	**60,327,457**

Pjesa më e madhe e mjeteve monetare më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë mbajtur pranë institucioneve financiare të listuara në tabelën e mëposhtme:

Banka	2014	Vlerësimi	2013	Vlerësimi
BNP PARIBAS S.A.	2,288,556	A1*	2,690,282	A2*
HSBC Bank	2,103,237	Aa3*	2,247,048	Aa3*
Societe Generale Albania	780,202	A2*	2,114,134	A2*
Credit Agricole Albania	166,808	A2*	568,486	A2*
Intesa San Paolo Bank Albania	70,431	BBB+**	429,750	BBB+**
ProCredit Bank Albania	126,594	B**	411,402	B**
Banka Kombetare Tregetare***	323,174	AAA	389,646	AAA
Alpha Bank Albania	58,443	B-**	280,082	B-**
National Bank of Greece Albania	68,234	B-**	149,521	B-**
Tirana Bank	5,832	B-**	148,166	B-**
Raiffeisen Bank Albania	17,998	A**	14,007	A**
Të tjera	164,871		42,973	
Total	**6,174,380**		**9,485,497**	

*Shoqëritë mëmë janë të vlerësuar nga Moody's për fuqinë financiare dhe likuiditetin afatgjatë.

**Vlerësimi nga Fitch Ratings për rrezikun e kredisë afatgjatë të Bankës më 31 dhjetor 2014 dhe 2013.

***Klasifikuar nga JCR-ER

26. Instrumentet financiare (vazhdim)

a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Gjithë institucionet financiare të mësipërme ruajnë pozicion të fortë dhe disponibilitet kreditimi të lartë kundrejt krizës financiare që preku kryesisht sektorin bankar. Drejtimi i shoqërisë duke ndjekur udhëzimet e thesarit të grupit OTE, ndërmerr gjithë masat e nevojshme për të minimizuar ekspozimin e mundshëm financiar.

Obligacionet e mbajtura deri në maturim janë të emetuara nga OTE plc, Mbretëri e Bashkuar. OTE plc është vlerësuar nga S&P me BB (2013: BB-)

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas rajoneve gjeografike (pas zhvlësimit) ishte si më poshtë:

	2014	2013
Brenda vendit	871,518	924,519
Shtete të tjera	419,214	729,588
	1,290,732	**1,654,107**

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë për llogaritë e arkëtueshme në datën e raportimit sipas llojit të klientëve (pas zhvlerësimit) ishte si më poshtë:

	2014	2013
Operatorë telekomunikacioni	542,303	831,669
Abonentë me kontratë	585,045	558,276
Distributorë për abonentët me parapagesë	109,972	226,445
Të tjerë	53,412	37,717
	1,290,732	**1,654,107**

Humbjet nga zhvlerësimi

	2014	2013
Llogari të arkëtueshme bruto	3,220,861	4,677,518
Zhvlerësimi	(1,930,129)	(3,023,411)
Llogari të arkëtueshme neto	**1,290,732**	**1,654,107**

Lëvizja e zbritjes për zhvlerësimin e llogarive e arkëtueshme gjatë vitit të mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është si vijon:

	2014	2013
Gjendja në fillim të vitit	(3,023,411)	(3,013,641)
Zhvlerësime të llogarive të arkëtueshme të rimarra	1,158,001	95,467
Shtesa gjatë vitit	(64,719)	(105,237)
Gjendja në fund të vitit	**(1,930,129)**	**(3,023,411)**

Transferimet që kualifikohen për çregjistrim të aktivit financiar në tërësinë e tij

Shoqëria ka transferuar llogaritë e arkëtueshme në transaksione që kualifikohen për çregjistrim në periudhën aktuale një shoqërie faktoringu ndaj të cilës shoqëria nuk është e ekspozuar pas transferimit.

26. Instrumentet financiare (vazhdim)

a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Gjatë vitit 2014, një pjesë e borxheve të vjetra me vonesë përpara vitit 2014 i janë shitur një pale të tretë për një shumë prejt 154,264 mijë Lekë. Shuma prej 952,271 mijë Lekë është transferuar.

	31 dhjetor 2014		
	Vlera e mbartur e aktiveve përpara transferimit	Vlera e mbartur e aktiveve që njësia vazhdon të njohë pas transferimit	Vlera e mbartur e deyrimeve të lidhura
Llogari të arkëtueshme (bruto)	1,213,332	-	-
Në			
Shitja e llogarive të arkëtueshme	*1,047,683*	-	-
Transferim i llogarive të arkëtueshme	165,649	-	-
Detyrimet e lidhura (garancitë)	106,797	-	-
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	(1,106,535)		-
	-	-	-

Shuma totale e humbjeve nga zhvlerësimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 ka vlerën 64,719 mijë Lekë (2013: 105,237 mijë Lekë). Humbja nga zhvlerësimi është provigjonuar bazuar në normat historike të mosshlyerjes. Rënia e humbjeve nga zhvlerësimi gjatë 2014 është rezulatat i rritjes së arkëtimeve të klientëve me kontratë gjatë vitit, shitjes së borxheve të vjetra dhe rënies së faturimeve mesatare të abonenteve me kontrate.

24. Instrumentet financiare (vazhdim)

a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Analiza e vjetërsisë së aktiveve financiare paraqitet në tabelën në vijim:

	Vlera e mbetur	Pa vonesë dhe të pa zhvlerësuara	Me voneseë por të pa zhvlerësuara			Të zhvlerësuara		
			Më pak se 1 muaj	Nga 1 në 2 muaj	Nga 2 në 3 muaj	Nga 3 në 6 muaj	Nga 6 muaj në 1 vit	Mbi 1 vit
31 dhjetor 2014								
Llogari të arkëtueshme	3,220,861	598,076	30,139	35,760	114,781	178,585	210,790	2,052,730
Provigjon për borxhin e keq	(1,930,129)	-	-	-	-	-	-	(1,930,129)
Llogari të arkëtueshme afatshkurtra nga palë të lidhura (shënimi 27)	817,330	777,818	33,388	512	226	2,188	2,739	459
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (shënimi 27)	54,349,726	54,349,726	-	-	-	-	-	-
Interes i përllogaritur (shënimi 27)	1,109,975	1,109,975	-	-	-	-	-	-
Totali i huave dhe llogarive të arkëtueshme	**57,567,763**	**56,835,595**	**63,527**	**36,272**	**115,007**	**180,773**	**213,529**	**123,060**
Mjete monetare	6,176,349	-	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	**63,744,113**	**56,835,595**	**63,527**	**36,272**	**115,007**	**180,773**	**213,529**	**123,060**
31 dhjetor 2013								
Llogari të arkëtueshme	4,677,518	1,085,140	139,059	40,334	15,219	111,412	8,362	3,277,992
Provigjon për borxhin e keq	(3,023,411)	-	-	-	-	-	-	(3,023,411)
Llogari të arkëtueshme afatshkurtra nga palë të lidhura (shënimi 27)	455,069	428,611	23,213	2,889	203	(290)	(66)	509
Hua të arkëtueshme afatshkurtra dhe afatgjata dhe aktive financiare të mbajtura deri në maturim (shënimi 27)	48,401,853	48,401,853	-	-	-	-	-	-
Interes i përllogaritur (shënimi 27)	329,009	329,009	-	-	-	-	-	-
Totali i huave dhe llogarive të arkëtueshme	**50,840,038**	**50,244,613**	**162,272**	**43,223**	**15,422**	**111,122**	**8,296**	**255,090**
Mjete monetare	9,487,419	-	-	-	-	-	-	-
Totali i aktiveve financiare	**60,327,457**	**50,244,613**	**162,272**	**43,223**	**15,422**	**111,122**	**8,296**	**255,090**

26. Instrumentet financiare (vazhdim)

a) Rreziku kreditor (vazhdim)

Kategoria "pa vonesa dhe të pa zhvelrësurara" përbëhet nga sa më poshtë:

	2014	2013
Abonentë të telefonisë celulare	120,972	167,290
Distributoret kryesorë dhe klientë të tjerë	55,284	225,728
Roaming	132,361	166,207
Operatorë telekomunikacioni	275,542	517,309
Klientë të tjerë	13,917	8,606
Totali	**598,076**	**1,085,140**
Detyrime nga palët e lidhura	**777,818**	**428,611**

Detyrimet e tjera nga palët e lidhura janë kryesisht me Cosmote SA, shoqëria mëmë e drejtpërdrejtë e së cilës është OTE SA, me vlerësim BA3 në Corporate Family Rating (CFR), vlerësuar nga Moody's.

b) Rreziku i likuiditetit

Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të detyrimeve financiare:

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2014 (shënimi 4 (b))	Vlera e mbetur	Deri në 1 muaj	1 në 3 muaj	3 muaj në 1 vit
Furnitorët	2,147,750	1,135,986	710,619	301,145
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënimi 27)	1,383,670	1,376,485	7,185	-
Shpenzime të përllogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra	443,748	443,748	-	-
Totali i detyrimeve financiare	**3,975,168**	**2,956,219**	**717,804**	**301,145**

Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2013 (shënimi 4 (b))	Vlera e mbetur	Deri në 1 muaj	1 në 3 muaj	3 muaj në 1 vit
Furnitorët	2,627,611	1,834,882	676,053	116,676
Detyrime ndaj palëve të lidhura (shënimi 27)	942,049	897,726	44,323	-
Shpenzime të përllogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra	407,976	407,976	-	-
Totali i detyrimeve financiare	**3,977,636**	**3,140,584**	**720,376**	**116,676**

c) Rreziku i monedhës

Ekspozimi ndaj rrezikut të monedhës

Ekspozimi i shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 ishte si më poshtë :

	Vlera e mbetur 31 dhjetor 2014	Euro	USD	Lekë
Llogaritë e arkëtueshme dhe huatë	57,567,762	57,013,880	6,167	547,715
Mjete monetare	6,176,349	5,479,699	48,141	648,509
Detyrime financiare	(3,975,168)	(2,861,253)	(304,189)	(809,726)
Ekspozimi neto	**59,768,942**	**59,632,326**	**(249,881)**	**386,498**

26. Instrumentet financiare (vazhdim)

c) Rreziku i monedhës (vazhdim)

	Vlera e mbetur 31 dhjetor 2013	Euro	USD	Lekë
Llogaritë e arkëtueshme dhe huatë	50,840,038	49,697,400	24,808	1,117,830
Mjete monetare	9,487,419	6,616,507	371,531	2,499,381
Detyrime financiare	(3,977,636)	(2,421,371)	(30,129)	(1,526,136)
Ekspozimi neto	**56,349,821**	**53,892,536**	**366,210**	**2,091,075**

Kurset kryesore të këmbimit të përdorura gjatë vitit:

Në Lekë	Kursi Mesatar		Kursi i datës së raportimit	
	2014	2013	2014	2013
USD 1	105.48	105,80	115.23	101,86
EURO 1	139.97	140,27	140.19	140,42

Një ndryshim prej +/-5% në kursin e këmbimit në datën e raportimit do ta kishte rritur (ulur) kapitalin dhe fitimin me 2,523,754 mijë Lekë (2013: 2,533,073 mijë Lekë).

d) Rreziku i normës së interesit

Në datën e raportimit paraqitja e interesit të instrumenteve të shoqërisë mbi të cilat llogaritet interes ishte:

	2014	2013
Instrumente me normë fikse		
Depozita me bankat (shënimi 16 dhe 17)	710,773	2,323,949
	710,773	**2,323,949**
Instrumente me normë variable		
Kredi dhe aktive financiare të mbajtura deri në maturitet me palët e lidhura (shënimi 27)	54,349,726	48,401,853
	54,349,726	**48,401,853**

Analiza e ndjeshmërisë së vlerës së drejtë për instrumentet me normë fikse

Shoqëria nuk ka aktive ose detyrime financiare me normë fikse të njohur me vlerë të drejtë përmes fitim/humbjes.

Analiza e ndjeshmërisë për instrumentet me normë variable

Një ndryshim në normën e interesit me 100 pikë bazë do të ndryshonte kapitalin dhe fitim/humbjen me 461,972 mijë Lekë (2013: 435,617 mijë Lekë). Kjo analizë supozon se të gjitha variablat e tjera, veçanërisht ato në monedhë të huaj, mbeten konstante.

27. Palët e lidhura

Shoqëria ka marrëdhënie me palët e lidhura me shoqërinë mëmë të drejtpërdrejtë dhe atë përfundimtare, me shoqëritë me kontroll të përbashkët me Shoqërinë dhe filialet e këtyre shoqërive si dhe me drejtorët e bordit dhe ata ekzekutivë.

27. Palët e lidhura (vazhdim)

Hua ndaj Cosmote dhe obligacione të OTE plc

Shoqëria ka obligacionet e mëposhtme të mbajtura deri në maturitet në OTE plc në 2014. Përveç obligacioneve të mbajtura deri në maturitet, shoqëria ka patur kredi me Cosmote gjatë 2013. Kreditë e dhëna Cosmote janë ripaguar gjatë vitit, duke përfshirë principalin e kredisë prej 42,074,024 mijë Lek (299,700 mijë EUR) dhe interes të përllogaritur prej 518,317 mijë Lekë (3,694 mijë EUR). Ripagimi i parakohshëm u krye në bazë të vendimit të Grupit për të transferuar investimet midis shoqërive nga "hua dhe lloagari të arkëtueshme" në "aktive financiare të mbajtura deri në maturim", si obligacione me kupon zero.

Si rezultat, shoqëria ka blerë obligacione nga OTE plc në vlerën 387,677 mijë Euro (54,349,726 mijë Lekë) gjatë 2014 (2013: 44,999 mijë Euro (6,318,731 mijë Lekë) me normë efektive interesi 4.17%.

Obligacionet nuk janë zhvlerësuar në datën e raportimit.

Norma mesatare e interesit për vitin 2014 është 3.31% në vit (2013: 4.81%).

	2014	2013
Vlera e kuponit	56,618,510	6,548,370
Zbritja	(2,268,783)	(229,639)
Amortizuar në fund të vitit	1,109,975	114,819
	55,459,702	**6,433,550**

Obligcione në OTE plc më 31 dhjetor 2014

Data e kontratës	*Data e blerjes*	*Data e maturimit*	*Vlera e kuponit në Euro '000*	*Kosto në Euro '000*	*Zbritja në Euro '000*	*Në Lekë '000*
18.03.2014	19.03.2014	15.09.2015	99,699	103,851	4,151	13,977,178
19.03.2014	20.03.2014	15.10.2015	64,999	67,853	2,854	9,112,446
24.03.2014	26.03.2014	16.11.2015	94,999	99,459	4,460	13,318,284
26.03.2014	27.03.2014	15.12.2015	74,999	78,689	3,689	10,514,493
17.06.2014	18.06.2014	10.06.2015	52,979	54,008	1,021	7,427,325
Total			**387,675**	**403,860**	**16,175**	**54,349,726**

Hua të arkëtueshme nga Cosmote SA më 31 dhjetor 2013

Data e kontratës	*Data e disbursimit*	*Data e maturimit*	*Vlera në Euro '000*	*Norma e interesit (%)*	*Gjendja në Euro '000*	*Gjendja në Lekë '000*
17.04.2008	28.05.2008	28.05.2015	75,000	4.73	75,000	10,531,312
Afatgjata					**75,000**	**10,531,312**
04.02.2011	08.02.2011	08.02.2014	120,000	5.564	65,000	9,127,136
26.07.2013	29.07.2013	08.02.2014	50,000	4.73	40,000	5,616,700
26.07.2013	29.07.2013	08.02.2014	10,000	4.80	9,700	1,362,050
26.07.2013	29.07.2013	08.02.2014	60,000	4.37	60,000	8,425,049
26.07.2013	29.07.2013	08.02.2014	60,000	4.80	50,000	7,020,875
Afatshkurtra					**224,700**	**31,551,810**
Totali i huave të arkëtueshme nga palë të lidhura					**299,700**	**42,083,122**
Interesi i përllogaritur					1,525	214,190
Vlera kontabël neto					**301,225**	**42,297,312**

27. Palët e lidhura (vazhdim)

Obligacione të OTE plc më 31 dhjetor 2013

Data e marrëveshjes	*Data e blerjes*	*Data e maturimit*	*Kuponi në Euro '000*	*Kosto në Euro '000*	*Zbritja në Euro '000*	*Në Lekë '000*
19.07.2013	22.07.2013	13.06.2014	46,635	45,000	1,635	6,318,731
Total						**6,318,731**

Gjenda e llogarive me palët e lidhura

Gjendja e llogarive me Cosmote-në dhe palët e lidhura të tjera, nën kontrollin e përbashkët të shoqërisë mëmë përfundimtare, janë si vijon:

	2014	2013
Detyrime ndaj:		
Cosmote	515,835	614,088
Cosmorom	840	1,490
Germanos	14,524	16,141
OTE (trajnime)	-	450
OTE Academy	-	4,107
OTE Globe	39,045	17,872
Të tjera palë të lidhura	813,427	287,901
	1,383,671	**942,049**

	2014	2013
Detyrime nga:		
Cosmote (afatshkurtra dhe afatgjata)	-	42,083,122
Cosmote (interesa të përllogaritur)	-	214,190
OTE PLC (obligacione)	54,349,726	6,318,731
OTE PLC (interesa)	1,109,975	114,819
Cosmote	158,316	187,721
OTE Globe	114,752	104,078
Cosmorom	140	1,747
Të tjera palë të lidhura	544,123	161,523
	56,277,032	**49,185,931**

Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga më poshtë:

	2014	2013
Të ardhura		
Shërbime interkonjeksioni	1,715,975	1,794,073
Të ardhura interesi	1,528,548	2,171,163
Linja të marra me qira	102,416	97,546
Roaming & SMS interworking	38,454	12,719
	3,385,393	**4,075,501**
Shpenzime		
Shërbimet teknike, drejtuese dhe shërbime të tjera mbështetëse	770,076	788,321
Shërbime interkonjeksioni	371,637	198,047
Roaming & SMS interworking	18,054	18,279
Linja të marra me qira	5,372	12,871
Të tjera	15,660	9,192
	1,180,799	**1,026,710**

27. Palët e lidhura (vazhdim)

	2014	2013
Shpenzimet kapitale		
Kosto e pajisjeve të blera	4,084	11,401

Shoqëria mban një numër lidhjesh tregtare dhe marrëveshjesh me Cosmote-në (aksioneri kryesor i COSMOHOLDING Albania sh.a., shoqëria mëmë direkte e AMC) të cilat lidhen kryesisht me:

(i) Marrëveshje për shërbime konsulence që lidhen me përgatitjen, instalimin dhe funksionimin e rrjetit të shoqërisë, për aktivitetin tregtar si dhe aktivitetin e saj të përditshëm.

(ii) Mbështetje teknike dhe drejtuese dhënë nga Cosmote.

(iii) Marrëveshja e interkonjeksionit me Cosmote dhe OTE Globe.

(iv) Marrëveshje shërbimi për kapacitet rrjeti dhe linjash me OTE Globe (përfshirë në shënimin 22).

Transaksionet me Cosmote (përfshirë në totalet e mësipërme) përbëhen si më poshtë:

	2014	2013
Shpenzime		
Shërbimet teknike, drejtuese dhe shërbime të tjera mbështetëse	737,450	755,442
Blerje të shërbimeve të telekomunikimit	-	(350)
Shërbime interkonjeksioni	35,529	14,802
Roaming	3,179	4,349
	776,158	774,243

	2014	2013
Të ardhura		
Shërbime Interkonjeksioni	519,126	607,876
Të ardhura nga interesi	304,126	1,857,340
Roaming	4,551	4,768
	827,803	2,469,984
Shpenzime të kapitalizuara		
Pajisje të blera	-	4,839

Shuma totale e shpërblimeve dhe honorarëve të dhëna drejtorëve dhe personelit kryesor ekzekutiv është përfshirë në shpenzimet e personelit (shënimi 8 dhe 9):

	2014	2013
Shpenzime Personeli		
Bordi i Drejtorëve	3,245	3,252
Drejtues ekzekutivë	129,444	99,375
Sigurime shoqërore	2,529	869
Pagesat e bazuara në aksione	-	2,881
	135,218	106,377

28. Pensionet e stafit dhe shpërblimet pas daljes në pension

Shoqëria nuk bën provigjone dhe nuk ka detyrime për pensionet e punonjësve mbi nivelin e kontributeve të paguara në fondin shtetëror të kontributeve për pension. Kontributet e shoqërisë për fondin e pensioneve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë njohur si shpenzime kur kanë ndodhur dhe arrijnë vlerën 80,410 mijë Lekë dhe 73,633 mijë Lekë respektivisht (të përfshira në shpenzimet e personelit në shënimet 8 dhe 9). Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2014 ishte 452 (2013: 471).

29. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

(i) Angazhime të qirasë operacionale

Më 31 dhjetor 2014, shoqëria është palë në një numër marrëveshjesh për qira operative të lidhura për qiranë e tokës së ndërtesave të cilat përfundojnë në data të ndryshme. Pagesat minimale që do të kryhen në të ardhmen sipas marrëveshjeve kryesore paraqiten më poshtë.

	2014	2013
Brenda një viti	157,273	172,149
Pas një viti por jo më shumë se pesë vjet	406,202	423,093
Më shumë se pesë vjet	254,734	266,963
	818,209	862,205

Shpenzimet e qirasë sipas këtyre kontratave për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 arrijnë respektivisht vlerën 210,242 mijë Lekë dhe 225,881 mijë Lekë dhe janë përfshirë në fitim/humbje (shënimet 8, 9).

(ii) Angazhime për shpenzime operative

Më 31 dhjetor 2014, shoqëria kishte një detyrim kontraktual për pagesën e një tarifa konsulence vjetore ndaj Cosmote për vitin 2015 në vlerën 756,193 mijë Lekë ose 5,397 mijë Euro (2013: 798,100 mijë Lekë (5,688 mijë Euro).

(iii) Angazhime për shpenzime kapitale

Më 31 dhjetor 2014, shoqëria ka një detyrim kontraktual për blerjen e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale prej 287,733 mijë Lekë dhe 239,741 mijë Lekë respektivisht (2013: 244,624 mijë Lekë dhe 218,156 mijë Lekë, respektivisht). Në datën e raportimit Shoqëria ka një angazhim për blerje inventari prej 304,311 mijë Lekë (2013: 425,828 mijë Lekë).

(iv) Roaming ndërkombëtar

Më 31 dhjetor 2014, shoqëria ka hyrë në një marrëveshje ndërkombëtare roaming me 377 operatorë GSM 900, 1800, 1900 dhe 3G në 156 vende (2013: 154 vende). Këto marrëveshje parashikojnë që kur një abonent i shoqërisë përdor shërbimin e një operatori korrespondent në një vend tjetër, shoqëria është përgjegjëse për pagesën e tarifave për këto shërbime në përputhje me tarifat përkatëse të operatorit ndërkombëtar përkatës (TON). Shoqëria i transferon këto tarifa tek klientët përkatës bashkë me një shtesë çmimi. Në mënyrë të ngjashme, kur një operator i një shoqërie tjetër korrespondente përdor rrjetin e shoqërisë, shoqëria i faturon tarifat për shërbimin operatorit përkatës sipas tarifave të operatorit ndërkombëtar të shoqërisë (TON).

(v) Çështje gjyqësore dhe pretendime

Shoqëria ka çështje të hapura me autoritetet tatimore nga vitet e mëparshme por drejtimi është i mendimit se ka argumenta të fortë në mbrojtje të pretendimeve tatimore të shoqërisë, duke pasur parasysh mjedisin e pasigurt tatimor në Shqipëri, dhe drejtimi është i mendimit se provigjoni për rreziqe tatimore është i kujdesshëm.

29. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

a. Penalitete nga autoritetet tatimore

Shoqëria ka hapur një çështje gjyqësore ndaj autoriteteve tatimore për sa i përket rivlerësimit të TVSH-së të bërë nga autoritetet tatimore ndaj të gjithë operatorëve në periudhën Janar – Tetor 2011. Vendimi fillestar i gjykatës ishte në favor të shoqërisë duke anuluar detyrimet e TVSH-së për shumën 154,200 mijë Lekë (1,098 mijë Euro) dhe vendosjen e një penaliteti prej 291,500 mijë Lekë (207 mijë Euro). Shoqëria apeloi këtë vendim në Gjykatën e Apelit të Tiranës. Gjykata e Apelit e transferoi çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit e cila nuk ka përcaktuar ende një datë për shqyrtimin e çështjes.

Përsa i përket inspektimit të tatim-fitimit për vitin 2010 dhe TVSH-së për periudhën 2010 – 2011, shuma e penaliteteve të TVSH-së e vlerësuar nga inspektorët tatimorë është 472,571 mijë Lekë (3,376 mijë Euro) kurse vlera për tatimin mbi fitimin është 81,626 mijë Lekë (583 mijë Euro).

Më 28 Mars 2014 gjykata administrative vendosi të shfuqizojë të gjitha detyrimet për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin vendosur Shoqërisë, me përjashtim të detyrimit të tatimit mbi fitimin dhe penalitetit prej 189,642 Lekë që rrjedhin nga mosnjohja e komisioneve të sponsorizimit dhe marrëdhënieve me publikun. Shoqëria apeloi vendimin. Gjykata e Apelit vendosi të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit në seancën dëgjimore më 3 Prill 2015.

Lidhur me përfundimin e inspektimit të tatimit mbi të ardhurat 2011 dhe 2012 dhe të TVSH-së për periudhën 11/2011 - 08/2013, raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përfshinte një penalitet të përgjithshëm prej 223,113 mijë Lekë (1,500 mijë Euro) dhe shumica e tij përbëhet nga penaliteti mbi faturat e shitjeve të kartave SIM të parapaguara të cilat janë konsideruar si fatura shitjesh për kartën SIM si një material i veçantë pa mbuluar kohë fillestare bisede të përfshira në atë paketë. Çështja është aktualisht në proçes.

b. Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës

Penalitet për dorëzim me vonesë të dokumenteve

Më 12 dhjetor 2005, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës vendosi një gjobë për shoqërinë në shumën 1,400 mijë Euro (1% e xhiros vjetore të shoqërisë për vitin 2004) me pretendimin e vonesës së përgjigjes ndaj një kërkese për informacion dhe dhënies së dokumenteve.

Çështja u mbajt pjesërisht në Gjykatën e Apelit. Shoqëria kërkoi gjithashtu rekurs të çështjes në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Lartë gjatë muajit Dhjetor 2013, vendosi që çështja të rigjykohet përsëri nga Gjykata e Apelit. Bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit në muajin Dhjetor 2014, shoqëria nuk do jetë e detyruar të paguajë penalitetin e vendosur prej 1,400 mijë Euro.

Penalitet për legjislacionin e konkurrencës

Më 9 nëntor 2007, Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës i vendosi AMC një gjobë prej 1,700 mijë Euro për një shkelje të pretenduar të legjislacionit të konkurrencës gjatë periudhës 2004 – 2005. Shoqëria ka apeluar vendimin në fjalë pranë Gjykatës së Apelit të Tiranës, e cila në seancën e datës 12 prill 2010 e gjykoi atë vendim të vlefshëm. Më 10 maj 2010, AMC ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë dhe vendosi një garanci bankare për pezullimin e ekzekutimit të vendimit (shënimi 16, 23). Gjykata e Lartë mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë dhe vendosi të kthejë çështjen në Gjykatën Administrative të Apelit.

c. Mosmarrëveshje të tjera

Shoqëria është subjekt i proçeseve të tjera ligjore, pretendimeve dhe mosmarrëveshjeve që lindin gjatë rrjedhës normale të biznesit. Drejtimi beson se kostot e nevojshme zgjidhjen e këtyre çështjeve nuk do të kenë efekt material në pozicionin financiar të shoqërisë, rezultatet e veprimtarisë apo flukset monetare.

30. Ngjarje pas datës së raportimit

Gjatë muajit Janar 2015, shoqëria rinovoi liçensen GSM për një periudhë 15 vjeçare. Kostoja totale e rinovimit ishte 1,525,019 mijë Lekë.

Gjatë muajit Mars 2015, shoqëria fitoi një tender publik të organizuar nga Autoriteti i Telekomunikacionit për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTES/WiMAX për një periudhe 15 vjeçare. Kostoja totale e të drejtave ishte 1,268,635 mijë Lekë.

Gjatë muajit Prill 2015, shoqëria fitoi tenderin publik të organizuar nga nga Autoriteti i Telekomunikacionit për blerjen e të drejtave për përdorim të spektrit të frekuencave 2500-2690 MHZ. Kostoja totale e këtyre të drejtave ishte 423,312 mijë Lekë.

Nuk ka ngjarje apo transaksione të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin shënime shpjeguese shtesë apo rregullime të këtyre pasqyrave financiare.